

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 207, Janar 2021

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

NDAL KËSAJ ² EKSTAVAGANCE TË ÇMENDUR MORTORE NË MES TË KOLERËS


Lindja dhe vdekja janë derivat i çdo frymori me arsye, diku në mes të tyre qëndron edhe martesat. Nëse gjuha është sistemi nervorë qendrorë, sistemi nervorë periferik i çdo kulture janë ritet e më sipërme. Këto rite në trajtat më tipike Iliro pagane + shartuar me element kristian u ruajt në Shqipërinë Epërme Katolike. Në Shqipërinë e ulet fushore bazamenti pellazgjiko-ilir u kalçifikua nga kultura osmane dhe bizantine. Dukagjini për vetë natyrën gjeografike dhe lirinë e tij natyrore është oazi më i virgjër, më pak i ndikuar dhe me arkaik i riteve iliro-arbërore. As kush në Evropë, Ballkan as në Shqipëri, jo që jo nuk tregojnë më për kujdes, respekt madje deri në tepri ndaj të vdekurve.

ANSAMBLI FOLKLORIK "TREVA E DUKAGJINIT" ZHVILLON KONCERTIN TRADICIONAL-2021, NË KUSHTET E PANDEMISË

Për të uruar këto festa gëzimi, me kënga, valle e çifteli, grupin "TREVA E DUKAGJINIT" nuk e ndal as pandemia. Është bërë traditë, që çdo fund viti, ansambli folklorik "TREVA" të organizojnë natën tradicionale të folkut Dukagjinas, me krijime të reja, duke promovuar vlerat më të mira kulturore e folklorike të Dukagjini ³



NDEROHEN ME ÇMIMIN ⁴ "AT" GJERGJ FISHTA-POETI I KOMBIT", POETJA LEDIA DUSHI DHE STUDIUESIT PRELE MILANI E LAZER KODRA



Mbi regjistrin kishtar të ⁵ Kishës së Shalës 1763-1863

- ZBULIMI I NJË DOKUMENTI ME RËNDËSI SHKENCORE DHE
DETAJET E PËRDORIMIT TË SHQIPES BRENDA TIJ -

HISTORIA E LEZHËS NDËR SHEKUJ ¹⁴

Qyteti antik i Lezhës cilësohet me emrin Lissitan. Janë bere disa zberthime etimologjike deri më sot nga dijetarë të ndryshëm. Është përngjasuar emri Lezhë, apo Liss me fjalën shqipe Lis çka përbën një etimologji popullore. Ka të tjerë që emrin Lezhë e lidhin me emrin e italizuar Alesio, ngaqë përmendet në dokumentet mesjetare shumë shpesh, me kuptimin Aleks, Aleksandër. Ky emër lidhet edhe me emrin e Llesh apo Lekë Dukagjinit, si derivate të emrit më të plotë Aleksandër. Këto shpjegime etimologjike janë gjithashtu në rrafshin e etimologjisë popullore, dhe duhet thënë, se emri topik Lissitan çka parakupton rrënjën Liss, është një emër i mirëfilltë ilir, kuptimi i të cilit, për arsye të një lartësie tepër të skajshme mund të themi ...

NDAL KËSAJ EKSTAVAGANÇE TË ÇMENDUR MORTORE NË MES TË KOLERËS



Prelë Milani

Lindja dhe vdekja janë derivat i çdo frymori me arsye, diku në mes të tyre qëndron edhe martesja.

Nëse gjuha është sistemi nervorë qendror, sistemi nervorë periferik i çdo kulture janë ritet e më sipërme

Këto rite në trajtat më tipike iliro-pagane + shartuar me element kristian u ruajt në Shqipërinë Epërme Katolike. Në Shqipërinë e ulët fushore bazamenti pellazgjiko-ilir u kalçifikua nga kultura osmane dhe bizantine. Dukagjini për vetë natyrën gjeografike dhe lirinë e tij natyrore është oazi më i virgjër, më pak i ndikuar dhe me arkaik i riteve iliro-arbërore. As kush në Evropë, Ballkan as në Shqipëri, jo që jo nuk tregon më përkujdes, respekt madje deri në tepri ndaj të vdekurve.

Ashtu si "Realit" i Madridit, nuk mund t'i dalë askush përpara për trofe edhe Du-

kagjinin, askush nuk mund ta konkurrojë në interpretimin me fanatizëm të këtij riti. Duke ngrënë e pijë si zotni në ritet dukagjinase kam dëgjuar, ata që përfaqësojnë kultura të ndryshme, duke qeshur dhe akuzuar për naivitet primitiv krahinore. Anise të gjitha llojet e kulturave mbi dhe ja nxjerrin dhembet njëra tjetres. Kjo kafyjtje herë e nxehtë, herë e ftohtë kësh-tu ka qenë që nga kopeja primitive deri te kopetë e sotme moderne. Gabimi më madh për brezat e ri ishte po të emitojnë shabllon ritet e kulturave të tjera ashtu si nuk ka perse të frikësohet askush nga ndikimet dhe huazimet më pozitive të tyre. Një banket serioz në nderim të atit, që ikën është detyrim moral për ata që mbetën dhe vlerësim për atë që ikën! Ai që të shtro tryezën nuk, ka asnjë përgjegjësi morale nëse dikush nuk dinë të rrijë si duhet. Aktualisht në këtë jetë kolere me vdekjet më të shpeshta ndoshta që nga kolera e moçme, zbatimi me pike e presje i protokollit sikur të ishte normalitet është IDIOTËSI DHE BUJARI E ÇMENDUR.

O ti njeri, baba dhe nëna jote që të vdesin, janë më të shtrenjtë në botë për ju, por jo për gjithë të tjerët. Nëna dhe baba juaj nuk janë as shenjtorë as heroi të pavdekshëm, që duhet përcjellë me kortezhe madhështore edhe në gjendje të jashtëzakonshme.

Ti o njeri, që më dërgon lajmin për vdekje në këtë situatë po më thua:

-Hajde, urdhëro në llogoren e pare nuk dihet se, nga pot shytojnë topat e Virus

Koronës. Unë po vij i tunduar nga respekti e detyrimi, kurse ti më nxjerrë përpara gjithë katundin, me qese të fryra duhani, pa maskë pa doreza. Unë trimi i "çartun" në krye të një çete të madhe sy leshe pa pikë vesvesja, përqafohemi, ngushëllojmë, por dhe ja themi thekshëm kafes rakisë. Kuvendi plot larmi nisë nga viktima deri te pulat, lopët, derrkucët, politika dhe gjeopolitika ndërkombëtare. Pa asnjë distancë, pa asnjë kujdes çohemi dhe shkojmë tek i vdekuri. Edhe aty me detyrim përcaktim shtrëngohemi duarsh dhe me një tabor grash, gjysma spektatore, që s'u bien ndermen se kush ka vdekë. Atëherë kur duhet iku dhe tu liroj vendin të tjerëve, nguli këmbët si mushka në burrinë time. Thumboj herë njërin here tjetrin, duke detyruar me pahir të më japi dorën edhe ndonjë "shkelës" të zakonit.

Grumbull në autobusë, e vetura nise-mi nder varreza. Atje, ndrysh nga pjesa e madhe që flasin e qeshin mbi pushime varresh, unë si i ndjeshëm dhe i "dashur" mbuloj në puthje të vdekurin, madje po që i mbuluar e zbërthej në mënyrë demonstrative arkivolin. Pas ritualit të gjatë sa një tërkuzë, rikthehem duke fole e qeshë me zë të lartë.

Në sheshin para lokalit tufa shembullore pret radhën për të hyrë në hetore. Plot një orë vazhdon mitingu ngreh e shty se kush do hy në radhe sipas nishave, që na ka pas dhurue per devocion rahmetliu Sulltan Hamiti. Pasi na kanë dalë djerset mbi xhaketë, shtrohet banketi 300-400

veta. Mirë na beftë ushqim e pija dhe shpiatrit ndera ju emri e bereqeti. Ndërsa policisë i rritë dreqi nderën që nuk ndër-hyn me shpërnda nga ky tubim më aventuresk se, thyesit e xhamave në Pazar.

Rituali që përfundon edhe një herë me duardhënie ngjeshur si fishekët në gjerdan. Shpërndahemi zhabë fryrë si lopët prej njomishte, pa ditë as gjë se kemi marrë ose dhëne shokut në krah barin e helmit. Punë madhe, pas tre ditësh rituali përsëritet, prape dalim në kullosë pa na u trembur syri.

O Zot ç' është gjithë kjo një lajthitje kolektive, si e atij që na pret si e jona që shkojmë yrysh si delet pas oqitit të vjetër zakonorë edhe kur ai hyn poshtë shkëmbit.

Unë që vij pa maskë tek ti nuk jam gjë tjetër veç një copë idioti. Edhe ti që më detyron të jap dorën gjithë lagjes nuk je gjë tjetër veç një i çmendur që ja ke ba mendjen lolo gjithë lagjes.

Unë dhe ti dhe gjithë Dukagjin ka mbi 6 muaj që sillemi, si pagan të laritur, të përlurur dhe përlotur para vdekjes dhe të shpërfillur marrëzisht për jetën, të cilin e kemi të dhëne dhurate vetëm një here

More kaq cungje nejçe jemi sa nuk latohemi hiç as në kohë lufte?

Zoti na ruajt pasi nuk dimë as ta duam, ta ruajmë njeri-tjetrin sa jemi gjallë, ndërkohë që gjithë dashurinë i rezervojmë vetëm për ditën e vdekjes.

Mbrojtja e fëmijëve nga politika

nga Lekë Imeraj

Tashmë jemi mësuar që në fushata elektorale, tribunat dhe paratribunat e partive politike, t'i shohim të mbushura me fëmijë. Dëgjojmë, që lider të ndryshëm politikë, urdhërojnë edhe mbylljen e shkollave, për të mbushur sheshet dhe tribunat me fëmijë.

Në raste të tilla dhe për çdo rast tjetër kur politikanët i përziejnë fëmijët me politikë, të jep të kuptosh, se ata nuk janë politikanë, por perversiteti i politikës.

Është paturpësi, e kundraligjshme, dhe akt kriminal, përzjerja e fëmijëve në politikë. Për mbrojtjen e fëmijëve, ka shumë ligje të posaçme, kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilët edhe një konventë ndërkombëtare, të cilën pushtetarët tanë të verbër nuk duan ta njohin. Të njëjtin vlerësim do t'u jepja edhe atyre drejtorë shkollash dhe trupave pedagogjike, që vetëm zbatojnë urdhra të tilla nga lart. Duhet t'i japim fund dhunës politike ndaj fëmijëve, dhunë e cila vjen nga politikanët sharlatanë, mashtrues,



gënjeshhtarë, shpifës, të cilët, të maskuar pas maskave të ndryshme politike, kujtohen për nxënësit dhe studentët, vetëm një herë në katër vjet, kur ju duhen për të mbushur sheshet dhe tribunat në fushatë elektorale. Këta të paftyre, edhe fëmijët mundohen t'i përçajjnë, si në kohën e diktaturës, në blu dhe rozë.

Nënkoshienca e adoleshentëve nuk është në gjendje që ta kuptojë dhe përpunojë një "parim" të tillë të politikës. Në shumë raste kjo sjell konflikte të ashpra midis të rinjve, në familje, në shkolla, në grupe dhe kudo.

Psiquka e adoleshentëve nuk është formuar deri në atë masë sa të mund t'i rezistojë dhunës emocionale që shkaktojnë fjalimet e liderëve politikë nga tribunat e mitingjeve.

Shkalla e ndërgjegjësimit të adoleshentëve, për arsye të mungesës së përvojës dhe të njohjes, nuk është në gjendje që të bëjë dallimin midis të rëndësishmes, të zakonshmes dhe normales. Në shumë raste ata, atë që është fare e zakonshme dhe e parëndësishme, por që politikanët e bëjnë

nga më të rëndësishmet, e marrin jo vetëm si shumë të rëndësishme, por edhe jetike.

Kjo mund të sjellë pasoja të rënda, psiqike dhe shpirtërore tek adoleshentët.

Nga propaganda urryese e partive politike, ndja kundërshtarit të vet, ata mësojnë që ta shikojnë dhe vlerësojnë ligësinë me ngjyra, duke u përçarë në militantë, të partive politike.

Sistemi i vetëmbrojtjes tek adoleshentët nuk është i pajisur akoma me elementet e nevojshëm që të përballojë dhunën e makinës së rëndë politike.

Të menduarit dhe të arsyetuarit tek ata, nuk janë formuar deri në atë shkallë, sa të jenë në gjendje të bëjnë "sitjen" e pallavrave të politikanëve nga tribunat, nëse ato janë të vërteta, të nevojshme dhe të mira. Në të shumtën e rasteve, premtimet e politikanëve nuk janë gjë tjetër veçse gënjeshtra, shpifje dhe mashtrime. Ato nuk kanë të bëjnë fare me të vërtetën, me të drejtat dhe lirinë e personit, as me nevojat e njerëzve dhe as me mirëqenien e tyre. Nëse adoleshentët do t'i marrin këto për të vërteta, do të zhgënjehen, do të përjetojnë konflikte dhe kriza.

Është fare e natyrshme që midis dy liderve politikë, një adoleshent të shkojë

pas atij që premtion shumë, dhe jo pas atij që qëndron më afër së vërtetës me premtimet e tij. Fundi do të jetë zhgënjimi.

Detyrë numër një e propagandës së makinerisë së rëndë të politikës është, që të shpallë trurin njerëzve, me qëllim që të besojnë dhe të shkojnë pas një lideri mashtrues. Kjo propagandë mundohet që të gjithë njerëzit t'i bëjë skllevër të një force të caktuar politike dhe të liderit të saj. Shkollat dhe universitetet duhet të depolitizohen dhe departizohen. Shkolla e politizuar prodhon vetëm merioneta politike, dhe jo të arthmen e kombit.

Mësuesët dhe profesorët e politizuar, janë rreziku potencial në shkolla dhe universitete. Shumë prindër, vazhdojnë ta mbajnë helmin dhe urretjen e tyre brëndave vetes, por jo për veten e tyre. Ata ua përcjellin fëmijëve të tyre, duke helmuar psiqikën dhe shpirtin e tyre, duke i shndërruar në të vetburgosur të përjetshëm.

Babai i mirë, i zgjidhë vetë konfliktet me të tjerët, jashtë mureve të shtëpisë. Ai nuk çon sherre në shtëpi, nuk mbjell dhe trashëgon urretje tek pasardhësit e vet.

Ne jemi një popull i vogël, aq sa të gjithë, diku dhe në njëfarë mënyre, jemi të lidhur me të gjithë, pavarësisht nga bindjet politike, besimet fetare dhe prejardhja krahinore.

Larg fëmijët nga politika!

Mjaft me përçarje!

ANSAMBLI FOLKLORIK “TREVA E DUKAGJINIT” ZHVILLON KONCERTIN TRADICIONAL-2021, NË KUSHTET E PANDEMISË

Për të uruar këto festa gëzimi, me kënga, valle e çifteli, grupin “TREVA E DUKAGJINIT” nuk e ndal as pandemia. Është bërë traditë, që çdo fund viti, ansambli folklorik “TREVA” të organizojnë natën tradicionale të folkut Dukagjinas, me krijime të reja, duke promovuar vlerat më të mira kulturore e folklorike të Dukagjinit.

Organizimi i kësaj veprimtarie ketë vit ishte e veçantë sepse u zhvillua në kushtet e pandemisë, në mungesë të spektatorit, por që ai u transmetua në netët e vitit të Ri nga mediat lokale si: TV Star plus apo TV Kopluku, koncert që pati shikueshmëri të lartë dhe u prit shumë mirë nga shikuesit dukagjinas e më gjerë. Kjo veprimtari u zhvillua në mjediset e BAR-RESTORANT “TRADITA”, në këtë mjedis të kulturës dhe traditës tonë kombëtare, në saj të bujarisë së dashamirësit të artit, sidomos atij burimor, të pronarit të këtij lokali, zotit GJON DUKGILA. Nuk është hera e parë që Ai kontribuon në zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike e promovuese nga dukagjinasi. Për këtë gatishmëri meriton falënderimet e veçanta. Kjo veprimtari meriton vlerësimin maksimal edhe për faktin se u zhvillua në kushte të vështira për shkak të pandemisë, pa mundësori financiar, me pjesëmarrje të kufizuar të interpretuesve, sidomos nga ata që janë në emigracion, me kohë të pamjaftueshme dhe mungesë ambienti për të bërë prova. Asnjë fond modest që ju premtoja nga bashkia e Shkodrës nuk ju dha. Kjo është një mungesë përgjegjësie e përsëritur nga ana e saj në një kohë që mundëson financiarisht gjithë çfarë veprimtarish më me shumë pak vlera se veprimtaria në fjalë. Megjithatë u zhvillua. Madje mjaft cilësisht, në saj të gatishmërisë së pjesëmarrësve dhe sidomos përkushtimit dhe vitalitetit të kantautorit Fran Kodra dhe Ndue Shytani, respektivisht drejtues artistik e organizativ si dhe interpretues mjaft të mirë, me një repertor të shumtë e shumë të pëlqyeshëm. Nuk duhet mohuar, por vlerësuar edhe puna e bërë në audio nga Luan Dakistani; koreografia e Aldo Nikes, grupi i të cilit shoqëroj të gjitha interpretimet si dhe puna cilësore e profesionale e studio Valbonës me shaljanin e mirë e të gatshëm Mhill Cak Vata.

Si u zhvillua kjo veprimtari?

Dhe siç është traditë, koncerti hapet me një akapelo, me thirrjen bashkë si dukagjinasi, pastaj këngëtarja Vjoleta Shqau përshëndeti në emër të ansambllit duke ju uruar të gjetheve vitin e Ri – 2021 sa më të begatë duke lenë pas një vit të vështirë, të paharruar, me dhimbje, ndarje e fatkeqësi. Hapja shoqërohet me vargje, në formë bejte, si kartolinë për çdo këngëtar interpretuar nga Gac Kodrina e Qazim Qela. Ja disa vargje: “me u uru këto festa gzim / kënga, vallja e çiftelia / grupin Treva të dukagjinit / nuk e ndal as

pandemia”. Apo: “n’daç me u knaq kur t’bajsh me ndie / boll larg vetit ja kan çue zanin / n’daç trimni n’daç kang dashnie / kem Fran Kodren e Ndue Shytanin” e të tjera.



Kënga e parë ishte ‘si shaljanet e dukagjinit’ interpretuar nga e ftuara speciale nga Malësia e Madhe, Elvira Fierza. Në këtë këngë harmonizohen figurat kryesore të krahinës së Shalës në momente të ndryshme historike si dhe vetitë e virtytet e tyre. Kjo këngë himn ka për autor shaljanin Pjeter Kola nga fshati Gimaj. Ja disa vargje: “n’daç për nder e per burri / n’daç për bese e për trimni / e kan than qysh prej fillimit janë shaljanet e Dukagjinit”.

Këngëtarit i mirënjohur e zemërmadh Gjovalin Shani u paraqit me këngën, ‘du me t’vet moj çifteli’, këngë e cila tregon problematikat e emigrimit të shqiptareve. Si gjithmonë, treshja simpatike Bardhok Perbibaj, Fran Kodra e Ndue Shytani interpretuan shumë cilësisht këngën “Jeta po sillet”, në të cilën nder të tjera, ja disa vargje: “jeta po sillet / kujtimet ruhen / zjarri e dashuria / peshohen kur shuhen”.

Si për çdo vit, edhe në këtë veprimtari, është gërshetuar elementi i ri me të vjetrin. Pati pjesëmarrës të rinj, që nder to ishte studentet dukagjinase Aurela Mushcaj dhe Emanuela Neçaj, të cilat interpretuan shumë mirë këngët respektive “Mbaje n’ zemër vendin tan” dhe “Kur të pata nuk ta dita” apo Zef Marku me këngën “Një kujtim”.

Përsëri dyshja Kodra-Shytani me krijimin më të ri, me titull “Para shqipes që kem nan”, në të cilën janë këto vargje: “Para shqipes që kem nan / nuk ka kryq as gjysem han / para vendit ku kem le / s’ka parti as fe”. Si gjithëron Geg Shpati u

paraqit me një parodi gazmore ku fshikullon plagët që shoqëria e sotme ka sjellë.

Nuk kishte si të mungonte në këtë veprimtari bylbylia i folkut verior, këngëtarja e talentuar Gofile Pappleka, e cila me zërin

tin Sokol Gjoni nuk e kishim parë ndonjëherë duke kënduar, por kësaj radhe na impresionoj me këngën e kënduar nga Ai me titull “Katër lule me kunor”. Në këtë veprimtari e pamë edhe se si pjesëtar të orkestrës e çiftelive të shoqëronin këngët.

Si gjithnjë edhe kësaj radhe nuk mungoj humori i shumë krijuesve, miqve të ansambllit Treva- Gac Kodrina e Qazim Qela. Mbresëlënëse ishte interpretimi i këngës “JETA FAT E FATI DRIT” nga këngëtarit me shumë perspektiv Kristjan Zalli. Ja disa vargje të kësaj kënge: “Daç, me t’lan fjale e djal / merre nusen n’Shosh e n’Shal / ai qe s’don me u pendue kurr / shkon ne Nikaj e Mertur / n’daç me marr jetën me t’mire / mere nusen veç n’Kir / kush e don nuse tabanit / ai t’bahet dhander Planit / me t’shnrit fatin tan / hajt e mere nusen n’Xhan / mos me i gjet askush mahan / shkon në Shllak, Temal e Toplan”. Një mbyllje mjaft të mirë i bën programit kuarteti Kodra, Shytani-Fierza e Shqau me këngën “Ndryshoj bota”.

Pothuajse të gjitha këngët ishin me tekste e muzikë të kantautorit Fran Kodra, krijimtaria e të cilit është shumë e pëlqyeshme kudo ku flitet shqip. Është furnizuesi me këngë të këngëtareve kryesor të Shqipërisë Veriore. Do kishim dëshirë të kishim edhe të tjerë të kësaj gjinie. Shkëndijat e para dhe shumë cilësore po i jep Pjeter Kola.

Ky koncert, me këngët, vallet dhe kostumet e traditës ishte një vlerë e shtuar dhe një pasurim i trashëgimisë kulturore të Dukagjinit.

Pasqyruam shkurtimisht paraqitjen e koncertit të fund vitit pandemik nga ansambli “Treva”, ku kjo veprimtari ishte shumë cilësore po të kemi parasysh kushtet dhe mundësitë në këtë vit të mbrapsht që lamë pas. Kështu që organizatorët dhe interpretuesit meritojnë vetëm përgëzime. Sigurisht që në qoftë se kjo natë tradicionale do të zhvillohej në kusht të njëjta si netët paraardhëse, meritonin edhe mendime ndryshe. Në këtë koncert duheshin më shumë instrumente popullore të zonës së Dukagjinit, në veçanti lahuta, pjesëmarrje më të gjere të këngëtareve dukagjinasi kudo janë meqenëse i kemi plote dhe me cilësi të larte interpretuese dhe më shumë krijues tekstesh dhe të mos jene vetëm të një autori, siç është Fran Kodra, i cili për punën që bën çdo fjalë për ta falënderuar është pak.

Shpresojmë që edhe në të ardhmen të vijohet tradita, me veprimtari sa më cilësore, jo vetëm në fund të vitit por edhe gjatë tij, me sa më shumë krijimtari për ta pasuruar ende më shumë trashëgiminë kulturore e artistike të Dukagjinit, me sa më shumë krijues e interpretues, me besimin se vit si ky, që lamë pas nuk do të kemi më.

Prele SHYTANI,
Shkodër Janar 2020

Përsëri Frani e Ndoja me këngën ‘Nuk është kanga për gjithkan’, shoqëruar me vargje humoristike nga Qazim Qela e Gac Kodrina. Nder të tjera, ja disa vargje: “çifteli dum me t’kshillue / mos prano gjithkujt me i knue / dum me i than sot telit tan / nuk është kanga për gjithkan”. Mos është një autogol? Këngëtarit i ri Zef Nika interpretoj këngën lirike “Ç’na ka zan plakun dashnia’. Plaku ankohet se i shkoj takati dhe i mbetet maraku. E pëlqyeshme për shikuesit ishte kënga lirike “Hajde çikë” e kënduar nga F. Kodra, N. Shytani dhe Elvira Firza. Violinis-

Nderohen me çmimin “At’ Gjergj Fishta-Poeti i Kombit”, poetja Ledia Dushi dhe studiuesit Prele Milani e Lazer Kodra

Sot në Vjenë, me 30 dhjetor 2020, pas disa javësh nominime, është ndarë Diploma “AT GJERGJ FISHTA – POETI I KOMBIT”, në këto fusha:

Juria ndërkombëtare e përbame nga Kryetare Nderi, Prof. Marianne Graf (Austri), At Vitor Demaj-OFM (Shqipëri), Vlora Ademi-Kosove, Ledri Kurti-Kraja-Shkodër, Gabriela Mujaj-Tiranë, Xhenc Bezhi-Salzburg, Ferdinand Nikaj-Londër, Gjergj Jozef Kola-Vjenë, **vendosi** me shpërblye me Diplomën- Çmimin prestigjioz, “AT GJERGJ FISHTA-POETI I KOMBIT”, këto personalitete të pendës mbarëshqiptare:

Poezi, Jozef Radi (Refrenet e trazueme) dhe Ledia Dushi (Femna s’asht njeri);

Drama, Primo Shllaku (Aktorë pa kujtesë)

Roman EX AEQUO, Marçel Hila (Zoti zbret në ferr); Elvi Sidheri Erdha pashe dashurova dhe Flutura Aça (Biri)

Përkthim: Ex Aequo, Vinçens Marku & Shqipe Marku “LETERSHKEMBIMI I FISHTES”; Albert Gjoka & Frida Vokopola “SKANDERBEG”

Publicistik: Gjoke Vata (Gegnishtja) Donika Dabishevci (Proza e poetizuar)

BOTUES: Martin Ndoja - VOLAJ

EXTRA: Cmimi i publikut: Monodrame, Odise Plaku, KLITHMA E NJË NËNE ...

Studime, Prele Milani - Lazer Kodra “DUKAGJINI YNË” – I, II, III e IV

Gjergj Jozef Kola,
Vjenë me 30. 12. 2020

Shenim: Artikulli i redaksisë së gazetës. Artikulli origjinal: “U NDA ÇMIMI “AT GJERGJ FISHTA-POETI I KOMBIT”, JA KUSH JANË FITUESIT”



Njoftim!

Me datën 17 janar 2021, në ambientet e Hotel “Rozafa”, u organizua një veprimtari përkujtimor për nder të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, por jo vetëm kaq. Pas kumtesave të rastit, Qendra e Artit dhe Kulturës Shqiptar dhe Stafi organizativ ndau mirënjohje por kompozitorin e njohur Zef Çoba, rapsodin Gjon Kosteri dhe poetin e publicistin Lulash Brigja.

Marrësit e këtij titulli nderi, në fjalën e tyre, në mes të tjerave theksuan: “Mirënjohja shkon për Bordin drejtues të QAKSh, znj. Margarita Xhepa (Nderi i Kombit) dhe z, Minedha Kureta (Mjeshtër i madh), që kane vlerësuar punën tone në shërbim të artit e kulturës shqiptare”.



Mbi regjistrin kishtar të Kishës së Shalës 1763-1863

- ZBULIMI I NJË DOKUMENTI ME RËNDËSI SHKENCORE DHE DETAJET E PËRDORIMIT TË SHQIPES BRENDIA TIJ -



Nga Mark Palnikaj

1

Në vitin 1911, Atë Lovro Mihaçević ka botuar në Zagreb një libër me titull "Po Albaniji – dojmovis puta". Në faqet 80 dhe 81 të librit të tij, duke folur për gjendjen në Ipeshkvinë e Pultit, ai ka shkruar se regjistri i kishës së Duzhmanit mbahet nga viti 1745, regjistri i kishës së Shalës nga viti 1763, regjistri i kishës së Plandit daton nga viti 1839.

Për kishën e Nikajve ai thotë se u dogj komplet në vitin 1867 dhe nuk shpëtoi asgjë. Për këtë kishë ai nuk bën fjalë për regjistrin kishtar të pagëzimeve.

Gjatë kërkimeve arkivore kemi gjetur se në vitin 1867, një besimtar i quajtur Arif Hasa, ka arritur të shpëtojë nga zjarri regjistrin e pagëzimeve, lindjeve dhe vdekjeve për kishën e Nikajve nga viti 1828 dhe në vazhdim.

Ky regjistër është përdorur nga ana jonë për të dhënat shumë të vlefshme që përmban për zonën por edhe për shkrimet në gjuhën shqipe të cilat janë publikuar nga ana jonë në librat, mediat e shkruara dhe ato televizive.

Regjistrat e kishave të Duzhmanit dhe të Plandit, megjithë përpjekjet tona, nuk ka qënë e mundur të gjënden. Ne nuk e dimë a janë zhdukur apo ndodhen në ndonjë arkiv ku ne nuk kemi mundur të hulumtojmë.

Mbas tre vjet kërkimesh intensive, kemi arritur të kemi të plotë, regjistrin e kishës së Shalës nga viti 1763 deri në vitin 1863, pra gjithsej 100 vjet të veprimtarisë së kësaj kishë.

Ai ka 213 fletë ose 426 faqe, të shkruara pothuajse të gjitha. Është i ruajtur mirë dhe dëmtimet janë të vogla dhe të parëndësishme.

2

Shkruarit e këtij regjistri, gjatë 100 viteve, në pjesën më të madhe të tyre, ja kanë dorëzuar njëri tjetrit me një deklaratë të shkruar. Gjatë kohës, ka shënime edhe për kontrollat nga organet eprore për vërejtjet dhe porositë për përmirësimin e mbajtjes së këtij regjistri.


Ai është i ndarë në tre pjesë. Pjesa e parë fillon me datën 2 janar 1763 dhe vazhdon deri më 27 mars 1849 dhe mbaron në faqen 156v. Në këtë pjesë të tij bëhet fjalë për pagëzimet e fëmijëve të lindur në fshatrat e ndryshme të famullisë së Shalës. Nga faqja 157r deri në faqen 197r ka informacion për lidhjen në martesë të çiftëve duke filluar nga data 13 janar 1763.

Nga faqja 198r deri në fund ka informacione për konvertime të femrave të besimit muhamedan në të krishtera kur ato ishin të martuara me burra të besimit të krishterë. Ka gjithashtu edhe regjistrime të rasteve të ndarjes së martesave të paligjësme siç është rasti martesave me dy gra, martesave me kunatën etj.

Në pjesën fundore ka të dhëna për dorzanët për ruajtjen e kishës ku janë të shënuar personat nga çdo fshat dhe funksioni i tyre në hierarkinë fisnore si bajraktar, vojvodë etj.

Në faqen 206v ka një shënim një faqe të plotë, shkruar nga Fra Pasquale nga Monte Alba me datën 12 gusht 1863.

Nga arkivistët, në kapakun e këtij regjistri ka të shkruar: "Regjistër lindjesh martesash e vdekjesh krahina e Du-



Kjo është data e fundit e regjistruar në këtë regjistër njëshekullor

kagjinit 1763 – 1849. Ka rëndësi studimi për onomastikën." Më vonë viti 1849 është shënuar si i pavlefshëm me një vizë të kuqe dhe si vit i përfundimit të shkruarjes së regjistrit është shënuar me laps të kuq viti 1859. Ky shënim rezulton të mos jetë i saktë sepse data e fundit e shënuar në faqen 206v konfirmon vitin 1863 si viti i shkrimit përfundimtar të këtij regjistri.

Ky regjistër ka rëndësi gjuhësore sepse na jep mundësi të dimë përdorimin e emrave nga banorët, emrat e fshatrave dhe lagjeve që sot nuk ekzistojnë dhe një numër të dhënash të tjera me rëndësi. Rëndësi shumë të madhe ka ky regjistër sepse ka një periudhë kohore prej gjashtë muajsh ku regjistrimet e pagëzimit të fëmijëve janë shkruar në gjuhën shqipe.

Në faqen 24v dhe 25r të këtij regjistri gjënden të regjistruar në gjuhën shqipe pagëzimet për tetë persona të regjistruar nga data 30 nëntor 1778 dheri me 5 maj 1779. Të dhëna më të hollësishme për këtë regjistrim do të gjeni në një artikull të zgjeruar i cili do të botohet më vonë nga ana jonë.

3

Regjistrimi i mëparshëm është kryer me 13 tetor 1778 dhe është i shkruar në gjuhën italyane dhe regjistrimi pasardhës i datës 10 maj 1779 është bërë gjithashtu në gjuhën italyane.

Në ato vite frat i Shalës ishte Mikel Angelo nga Akuta kurse në Kiri shërbente Frat Onofrio nga Bernarda e Basilikatës, edhe ky nga Italia. Regjistrimet në gjuhën shqipe janë bërë nga ky i fundit, i cili me sa duket për shkaqe të pa njohura nga ne, e ka zëvendësuar kolegun e tij për periudhën nëntor 1778 deri me 5 maj 1779.

Motivet që e kanë shtyrë Frat Onofrion për të bërë në gjuhën shqipe regjistrimet në regjistrin e lindjeve të kishës ne nuk i dime por ai me siguri njëjtë edhe gjuhën

rekt edhe në gjuhën shqipe, dialektin e Dukagjinit të vitit 1778.

Datat e pagëzimit të fëmijëve i ka shkruar në gjuhën e tij ose në gjuhën latine por jo në gjuhën shqipe.

Nuk është rasti i parë i shkrimit shqip në këtë Dioqezë nga ky prift, sepse kemi edhe dy raste të shkrimit në gjuhë shqipe më përpara, një rast në Shosh, pak kilometra larg Shalës në vitin 1761 dhe një rast tjetër të njohur në kishën e Plandit, edhe kjo jo shumë larg nga Shala ku frati i kësaj kishë, Ëngjëlli (Angelo) nga Braçiljano e provincës së Salernos kompozonte këngë në gjuhën shqipe për korin e murgeshave të kësaj kishë.

Pra ky frat, nuk ishte i vetmi që provon të shkruaj në gjuhë shqipe por ishin edhe disa priftërinj të tjerë të kësaj Dioqeze që kishin shkruar shqip. Në atë kohë gjuha shqipe nuk ishte e formësuar nga ana e shkrimit por, me sa duket, këta freret kishin kontakt me gramatikën e shkruar nga kolegu i tyre Françesko Maria nga Leçe në vitin 1716 me 274 faqe dhe të botuar në Romë.

Në kohën e sotme është paksa e vështirë të kuptohet ky shkrim sepse edhe vetë gjuha që flitet sot, edhe si dialekt, në zonën e Shalës ka pësuar ndryshime në raport me vitin 1778.

Kush e shkroi regjistrin e Famullisë së Shalës për 100 vjet, shtatë muaj e 12 dit, nga 1 janar 1763 deri 12 gusht 1863

Gjatë një shekulli patën rastin një numër i madh famulltarësh, vikarësh apostolik dhe ipeshkvinj të vinin dorë në këtë regjistër. Bëmë një identifikim të të gjithë personave që në një formë ose një tjetër kane punuar mbi këtë regjistër.

- Fra Ardiano da Funo Milanese 2 janar 1763
- Fra Ardicino, 4 maj 1765
- Fra Francesch Andera da Sospello 26 nëntor 1765

4

- Fra Bernardo da Zangarona 18 prill 1766.
- Pietro Vela da Porta Maggiore, vrare me 10 gusht 1767
- Fra Leopoldo da Rosignano, 24 gusht 1768
- Fra Domenico da Salma, 26 nëntor 1768.
- Fra Luigi Maria da Roma, 20 prill 1769 kontroll.
- Fra Idelfonso da Rimella, caktuar nga fra Luigi da Roma me date 24 gusht 1770.
- Fra Andrea da Periami, 18 tetor 1771.
- Fra Aloysio Maria da Roma Prefect Apostolik bën kontroll me dt 8 korrik 1772.
- Fra Michel Angelo da Acuto, 3 tetor 1773.
- Fra Onofrio da Bernarda, 15 korrik 1775
- Fra Antonio Maria da Sirone, 20 maj 1782
- Fra Serafino da Potenza Vascia, 30 maj 1782
- Fra Serafino da Limone, 20 shkurt 1773

italjane. Aktivitetin e këtyre freretëve e njofim për arsye të dokumentacionit të hollësishëm që kemi përpunuar kur kemi shkruar historikun e Dioqezës së Pultit. Do të riprodhojmë më poshtë shkrimin e dorës që gjendet në regjistër për dy regjistrimet e para.

"Lopsc, Die 30 9mbre 1778 (Lopçi 30 nëntor 1778)

Une F. Onof.º Pagheeva Palin Pietren, te bin t'Pjeter Peps', e Len Boghes. Me Cunor.

Un Frat Onofrio, pagezova Palin Pjetren, të bijën e Pjetër Pepës dhe Lenës nga Boga. Me kunorë.

Ab.º, Die 10 januarij 1778 (Abat, ditën e 10 janarit 1778, mendoj se viti 1778 duhet të jetë një gabim i shkruarit, duhet të ishte shkruar 1779 – M. P.)

Pagheeva Vat Prellin, te birin t'Prell Peps', e Len' Boghes. Me Cunor.

Pagëzova Vat Prelën, të birin e Prel Pepës dhe Lenës nga Boga. Me kunorë.

Nuk është e vështirë që të vihet re që shkruarit gjuhën shqipe nuk e kishte gjuhë amtare dhe e ka të vështirë të shkruaj kor-

ËNGJËJT ME BLUZA TË BARDHA

Nderim, përvulje dhe respekt për mjeken shkodrane, Dr. Lindita Dibra

I përhumbur në mendime gjatë këtij regjimi dhe izolimi të detyrueshëm për shkak të infektimit nga Covid 19, kur dita dhe nata nuk bëjnë shumë diferencë e ku kontakti me njerëzit është pothuajse i ndaluar, vendosa që mendimet t'i shpreh përmes këtij shkrimi me mirënjohje të thellë për ata njerëz që në rrugë të përshëndesim thjeshtë si gjithë të tjerët, por që në momentet kyçe të jetës nën mantelin e bardhë shndërrohen në engjëj mbrojtës të shëndetit e gardjanë të jetëve tona.

Megjithëse nuk është hera e parë që shkruaj për bluzat e bardha, pasi ndër shkrimet e mia rënditen disa artikuj për kirurgun Dr. Ardian Dajti, aktualisht Drejtor i Spitalit Rajonal të Shkodrës, Dr. Luan Bajri, anesteziist i mrekullueshëm, për kirurgun e parë shqiptarë Zyliha Kraja që para pak kohësh e humbi betejën me Covidin, e shumë të tjerë në të cilët veç jetës, punës dhe karrierës kam pasqyruar edhe kontributin e tyre personal në të mirë të shëndetit publik e kryesisht shëndetit komunitar të qytetit të Shkodrës.

Ndryshe nga herët e tjera, ndoshta i ndikuar edhe nga situata me të cilën po përballet mbarë bota dhe shoqëria njerëzore prej gati një viti, peshën e së cilës po e mbaj edhe unë këto ditë, vendosa të shkruaj me zemër, për t'i peshuar gjërat në vlerën e tyre maksimale.

Ndaj këtë shkrim ia dedikoj doktoreshës së Sanatoriumit të Shkodrës, pneumologes më në zë të qytetit tonë. Emri i saj aktualisht lakohet në çdo familje, tavolinë e bisedë telefonike, sapo bie fjala mbi këtë lëngatë tinzare e të pa besë. Është fjala për Dr. Lindita Dibra e cila gëzon vlerimin maksimal nga të gjithë pacientët dhe familjarët e tyre e ndoshta ky është vlersimi më i lartë që ata i bëjnë etikës së punës dhe aftësive profesionale që ajo promovon në përditshmërinë e saj.

Ashtu si përherë, i angazhuar pas punëve të përditshme, madje edhe skeptik në të besuar për rrezikun që mbart ky virus, e mora me të lehtë distancimin dhe zbatimin e rregullave mbrojtëse, pasi të jesh i lidhur me artin harron se egziston gjë tjetër veç bukurive të jetës, sepse vetë arti ka vetëm një stinë e kjo gamë



e gjërë mrekullish është pranvera e kësaj jete. Ishin orët e fundit të 2020-tës ku në përpjekje për t'i kryer ato pak punë të planifikuara me mediat dhe krejt i pavenueshëm ndaj vetvetes, trupi filloi të jepte sinjalet e para të prezencës së këtij virusi. Sërish i shpërfilla pasi ishte një natë gëzimi e urimet që vërshonin si lumë nga të katër anët e botës, kërkonin vemendje

tryeza u drejtova për në krevat.

Të nesermen dita më zbardhi me trup të këputur, me temperaturë, ethe e tepër i rënduar fizikisht e moralisht. Megjithëse u mundova të ndjek ritualin e përditshëm e kisha të pamundur të rezistoj, pasi forcat po me lëshonin e gjendja me doli jashtë kontrollit duke bërë që t'i drejtohem spitalit. Megjithëse Shkodra është një qytet



e respekt maksimal. Tryeza e Vitit të Ri ishte shtruar, e megjithëse m'u kujtua ajo batuta "çohu o i vdekur e haje një pulë të pjekur", në tryezë qëndrova vetëm për hirë të familjes dhe menjëherë pasi u ngrit

i madh, për t'i gjetur njerëzit e rëndësishëm të saj është shumë i vogël, pasi ata i njohin të gjithë, ndaj menjëherë telefonova doktoreshen e Sanatoriumit Dr. Lindita Dibra, e cila veç përgjegjshmërisë

së saj profesionale, ka dhunti e aftësi të jashtëzakonshme në komunikim me pacientin aq sa të duket sikur të shëron edhe me fjalë, për çka edhe i jam shumë mirënjohës.

Në pamundësi për të komunikuar me miqt dhe kolegët e mi vendosa të vë një njoftim në fb. të cilin e pushtuan komentet e urimet për rastin dhe unë, në pamundësi t'u përgjigjem personalisht, vendosa të shkruaj një falenderim të përbashkët të shoqëruar edhe me vargje, ku shpjegova edhe gjendjen time të përmirësuar falë mjekimit të Dr. Linditës, korrektësisë së infermierit Melvid Murçaku, dhe saktësisë profesionale e shkencore në analizimin e gjëndjes time kritike nga Dr. Fatoz Rrjolli, i cili me një kujdes të madh dhe me një përkushtim maksimal arriti të neutralizojë në mënyrë të shpejtë gjendjen time, falë edhe Laboratorit Klinik Biokimik ZAMA. Një tjetër falenderim tepër të përzemërt kam edhe për mikun tim të mrekullueshëm nga Vlora, Sejmen Gjokoli, i cili m'u gjet pranë në çdo moment me kujdesin dhe përkushtimin e tij të paçmueshëm, duke u konsultuar me bashkëshortin e tij mjek të specializuar, më këshillonte çdo ditë me një dashmirësi vllazërore për çka mirënjohja është e pa mjaftueshme.

Më ka lënë shumë përshtypje pozitive se si mjaftuan pak rreshta falenderimi për të ngacmuar komentuesit, të cilët me mesazhet e tyre mbushen të gjitha hapsirat e komunikimit në të cilat lexojë pafund fjalë të mira e vlersime maksimale për Dr. Lindita Dibra e jo vetëm, por edhe për të gjithë ata mjekë e infermierë që janë në vijën e frontit në këtë luftë planetare dhe që sot për të gjithë ne janë bërë heronjt e ditës. Heronj të vërtetë të shëndetit tonë të brishtë, të cilëve përveç mirënjohjes u kemi borxh një përvulje të thellë nderimi. Ndaj me të drejtë mund t'i quaj engjëj e heronj që si shmangen rrezikut, por vazhdojnë të mbrojnë jetët tona me jeten e tyre.

Ramazan Çeka,
Janar 2021

- Padre Eduardus da Bohemia, 8 nentor 1783. Ky deri me date 13 maj 1785 e ka plotësuar regjistrin ne gjuhe latine. Mbas kesaj date eshte kthyer Fra Michel Angelo në famulli.
- Fra Casimiro da Quattordio, 13 gusht 1778
- Fra Biaggio da Lu Augusto, 2 gusht 1789.
- Fra Michel Angelo da Carpineto, 27 gusht 1790
- Fra Eusebio da Solarola, 27 maj 1798
- Padre Emiliano da Zangarolo da Provincia di Romana, 14 shkurt 1805
- Fra Teodori di Ceva, nga 3 korrik 1806
- Fra Giuseppe da Torrano, nga 26 prill

- 1814
- Fra Antonino da Boscomare, nga 25 korrik 1824
- Fra Luca da Monte Giove, nga 22 mars 1826
- Pater Gabrielis Barassichi, kontroll me 27 prill 1829
- Fra Deodato da Costacciarra, 11 tetor 1826
- Padre Anacleto di Leprignano, 14 korrik 1830
- Fra Antonio d'Ascoli, 30 tetor 1832
- Fra Giorgio da Narni, 8 janar 1836
- Fra Francesco da Matera, 24 shkurt 1839
- Fra Giovanni da Faenza, 1 shtator 1839
- Fra Garifico da Cuneo, 11 maj 1840

- Padre Pietro da Barbara, 9 prill 1840
- Fra Raffaello da Bosco Reale, 8 qershor 1842
- Fra Oscario d'Imola, 22 qershor 1844
- Fra Anselmo di Onano, 11 qershor 1846
- Fra Stefano da Rallo, 5 shkurt 1847
- Fra Giuseppe Maria da Cosio, 18 shkurt 1847
- Fra Pasquale da Boscoreale, 20 nentor 1847
- Vesc. Pal Dodmasej, 24 qershor 1848
- Fra Taddeo d'Albano, 27 mars 1763
- Fra Ludovico da Sosta, 18 gusht 1854
- Fra Pasquale da Monte Alba, 12 gusht 1863

5
Dokumenti ka rëndësi shkencore sepse në shek.XVIII deri tani kemi vetëm letrën e fretërve të Pultit të vitit 1761 të shkruar në gjuhën shqipe edhe pse indirekt, nga dokumentat, merret vesh që edhe të tjerë kanë shkruajtur në gjuhën shqipe por deri tani, nuk kemi mundur t'i gjejmë.

Rëndësia e këtij regjistri është shumë e madhe dhe ne shpresojmë që në të ardhmen ta botojmë të plotë të pajisur me shpjegimet e nevojshme për lexuesit tanë.

Marre nga gazeta "DITA",
date 2 janar 2021

BAJNË KUVEND GJERGJI E LEKA!

(FTESË KUSH DO NJË MEDITIM QETËSUES TË LARGËT NDER VITE)

Gjergji Kastrioti i çoj fjalë Lekë Dukagjinit, hajde të përpiqena me u marr vesh për do gjyqe Shqipnie, Leka ju përgjigj .

-Të fala me shëndet e përndrtuni Skanderbek! Ndihem i vlërsuem dhe i nderuem e me kuvendue me ju si jetë e drejta dhe ma e mira për Arbninë tonë. Si mbas orokut të martën e Pashkëve u përpoqën te livadhi para Kishës së Shna Premtes në Skuraj të Kurbinit. Erdhën secili në kuaj të shkëlqyeshëm shale. Trimat që i shoqëronin për nevojë të merrini gjak në vetull por ishin edhe dijetar te rrahur ne dallga kuvendesh. Gjergji si mal krenar, vetull harkuar sy flakë, hundën me kurriz, fytyrën relativisht, të gjatë, po ashtu mjekrën e zezë të lulëzuar me thinja te arta fisnike. Veshun mbante kostum cohe veneciane e sh-trengue me tana takemet e një krye princi. Leka vinte i gjatë me pamje elegante me kësulë të bardhë, fytyrë lëmuar. Çfarë mustaqesh korb te dredhuna deri tek veshët, me jelek tradicional me pulla të arta hedhun mbi ta një mantel të hijshëm me shpatë me këllëf të argjendtë. I qeshun me vështrim të mprehtë ku bashkohen zgjuarsia dhe urtësia.

Korabi e mali e Bardhë[1] u morën grykë në kaltërimin e qiellit shkëlqimtare. U ulën rrafshit në hije të një mrizi hormoç në mes të një govate lëndinore rrethuar me hali të blertë. Zogjtë e malit i pritën me cicërima, orët po laheshin në kroje, pranvera e buzëqeshun u tha:

-Mirë se erdhe o shqipet vatanit! Sh-true kambë kryq, ndërruan kutitë e bademit dhe ja filluan kuvendit për luftën, kështjellat, Lidhjen e princave, fitoret, bjerrjet, rreziqet dhe shpresat. Për gjyqet dhe drejtësinë ndanin mendime te ndryshme ku Gjergji i thotë:

-Leke ti ke një Principate të madhe që ta la trashëgim miku im Pali që dritë i baft shpirti! Ke doket dhe Kanunin me emrin tand por mirë asht t'i shoshitim do gjana e te mos veprojmë secili në krye të vet sikur nuk na nxehtë një diell.

-Mana fort i ke lakmue, tokat e mija por nuk kam në mend me të lëshue as një kut! Boll i mirë je! Me t' pas anmik burri nuk si ta matë shpatën. Por qe besa Lekë Dukagjini veç në hije të Zotit rri dhe askujt tjetër, por ama edhe toka nu përmbystë me ke krah të djathtë!

-Lekë dashakqitë më patën fry në vesh se ti pate ngritë një pritë në Krrabë kundër meje. Mua më pati hipë një mërzi e madhe, i nxitun dhe ndihmuem nga Venetia ta mora Shatin. Ma vonë u binda se dikush kish dashtë me vra mue e me turpne ty. Në lufte, e në paq ma i keq se anmiku ashtë intriganti. Mendimet e mjegulla tash janë zvaritë dhe përkasin së shkueses. Por edhe ti ma pate ba një dredhi mi çove kufijtë e Mirditës deri te shtegu u ograjve të mija. Un u rrita në Adrianopojë

dhe të thash:

- Ti e din se ku i kishin kufijtë babat tanë, prandaj po la ty e nuk po marrim pleq, as nuk po i ndajmë me luftë?!

-Edhe unë i ndava siç kanë thanë motit? "Kush ndaftë e kjoftë kurrë mos këndoftë!"



Kur ti dyshove, atëherë për leverdi edhe mos me ba be të rreme, futa dheun e tokave mija në opinga dhe tu betova:

"Njetu jam mbi dhen tim që ka lanë baba!"

-Kjoftë për atëherë ajo lojë. Sot të kam thirr me fol e me nda se qysh po e lamë punën e gjykimit të gjaqeve.

Turkun e këna te dera që turret yrysh çdo verë. Në anën tjetër do syresh rradake shtjerrë baj kredinë mbi njerëzit e mirë, shumë trima prej gjakesh kanë mbet ndry kullave te ngujimit kur vendin e kanë në mejdan. Nuk e di me lufte ma parë osmanet, apo me shkulë këto ferra që kanë mbi vneshtave tona. Ti Lekë në kanunin tand e ke thanë:- "Gjaku shkon krye për krye". Kjo gja nuk më duket drejtë as e dobishme. Si mund të vihet në një peshore një krye-derr me kryet tand plot mend?

Si mund shkojë gjak për gjak një fisnik me një cub dhe i bekuemi me djallin?

Gjegji fliste e fliste ndërsa Leka tymoste duhanin, tue ulë e ngrate vetullat tue prit rendin me hy në bisedë. Ma në fund me dorën e djathtë fërkoji mustaqet, çeli pak gojën tue shprazë njështrungë tym duhani së bashku me pyetjen.

-Gjergji si ke mendue si me ja gjet vegën kësaj vorbe përvëluese?

-Si mbas mirësisë dhe rangut shoqnorë. Së paku për një të mirë me vu me dy të këqij. pse jo edhe ma shumë, vetëm kështu shkulet egjra prej grunit!

Leka thithi edhe ma fort duhanin, ngriti vetullat dhe lëshoj një shikim të çuditshëm drejt Gjergjit dhe ja filloi interpretimit.


- Në kanunin e maleve të mija djemtë lejnë, nihen të mirë e nuk veçohen njani prej tjetrit! Ku gjendet ai gjyqtare që mund me peshue sa i mirë asht dikush dhe sa të këqij peshon ky i miri. Fjala mort nuk mba, por larg kjoftë me vra dikush Skanderbegun i bije me shfarosë tanë Krujën. Qebesa kështu vrasa nuk pra, o pa qitë fare dikush shoqin o pa u ba gjaku

det. Çmimi i jetës asht njisoj si për të mirin dhe të keqin! Secili mbahet i mirë dhe askush nuk i thotë i keq vetit? "Jam burrë" e thotë . -"A je burrë"! Nuk mund të ketë gjykim e peshim tjetër si miri si keq mbahen rrumbull katërqind dërhem në okë të vet!

-More biri ju jeni dy krahët e një trupi, ora dhe ndera e këtij vendi. Kur nuk merreni vesh ju, kush ka me pleqnue mbi ju?!

-Loke m' kallëzo me drejtë t' Zotit, a jam ma i mirë unë, apo im atë?

-Pse ja ke futë vetit gjithë atë maraz biro? Ti nuk ma ke ba kurrë ketë pyetje



Gjergji nuk pati durim me ndie deri fund alegorizmat e prijësit të Kanunit dhe me nervozizëm thumboi.

-Ti Lekë, në çdo kuvend do me ja lanë vetit! Flet bukur, je kallauz, por edhe kokrra e sherrit. Sherrin e ka me dy të kuqa, njerëzit besojnë ma shumë ligjin tand se në ligjin e shenjtit!

-Gjergji bajagi me rendove me fjalë. Na u mblodhëm me pleqnue jo me ba duel, fjalësh.

-Jo, jo Lekë gjaku i të mirit nuk, do përzihet me gjakun e të keqit!

-Je i pari i vatanit shpatën ta vlerëson e çmon tanë kështëni, por: "I miri del prej të keqit dhe i keqi prej të mirit!"

-Lekë Dukagjini mos na kjoftë për hajër kjo godi: -tha Gjergji dhe bani shenjtit truprojës t'i sillte xhogan!

-Udhe të mbarë o lavdiploti, por ban mirë me pëvetë loken si e ke pas tatën, e si ke dal ti?!....

Pa të tjera fjalë Gjergji u largue si era, gjyqi mbeti vare e kuvendi u nda. Kryetrimi i mërzitun, nuk u ndal as te miku i bukës Kok Malçi qi kish ba gaty deshet e pjekun në hell për drekë mbas kuvendit.

Nuk i hahej as nuk i pihej, fjala e Lekës ju ngul si gozhdë në kaptinë dhe ja trazoj shpirtin si vala detin.

-E Lekë Dukagjini rrallë flet e larg vret!

Kur shkoj në oborr të pallatit gjeti nanë Vojsaven tue ba punë dore .

-Puna mbarë të kjoftë nanë e mirë ?!

-Mbarë paç e mirë se të pruni i madhi Zot!

-Pse lodhesh lokjo me therë gishtat me gjylpanë.

-Biro nana lodhet mos me ba diçka, ketë punë baj për qef jo për nevojë!

- Si te shkoj udha o luani i lokes? Po të shoh pak si vrantë në fytyrë, mos ke marrë ndonjë lajm jo të mirë?

- Jo, jo nuk kemi habere te reja lufte, por me lodhi Lekë Dukagjini. Debatuam gjatë për gjyqin e gjaqeve, ai të tijën e unë në timen dhe ndamë pa vu cak.

veç sot!

Loke amanet me kallëzo pa hile?

-Si me mbete pa sy si me të heq hile ty, more i miri im. Mbas do me ditë po them:

Qe besa im shoq para teje kje pak gja. Ai shkoj në atë jetë i lumtur si ma s'ka që iu ba djali me ja njoftë bota? Veç prindja do me ju ba ma i mirë djali se vetja!

-Gjergji e kish humbur toruan dhe bani një pyetje pa takt sikur të ishte krejt i pa soj.

-Tatës si pakam, ngja po kujt pra moj loke?!

- Tubestak, të vinë marre për pyetjen që banë! Thuaj rojeve t' ma nxjerrin karrocën e m' çon në kishë?

-Nuk asht vakt me shkue në kish tash moj nanë?

-Eja me mua dhe mos më pyet ma për kurrja.

Gjergji i nxehtë faj, i shkoj mbas pa ba za. Ece guxo me fole ma, e kishte pickue atje ku nuk duhej. Nanmadhja arbënore hyni në kishë si dritë epa prarueme, mori ungjillin bani kryq dhe u betua.

-Për ketë ungjill të Shmarkut "Je bima e trupit dhe zemrës sime dhe Gjoni Kastriotit dhe askujt tjetër". Ti je fort ma i mirë se yt atë, por në fytyrë dhe hundën krrulë i ke ngja Gjoni.

Gjergji i penduem e mori grykë dhe puthi si dikur kur ishte camërdhok!

M' falë nanë, nuk fola unë, por hija dyshuese e djallit, të cilën bekimi jot e vrau tek unë!

Më fal Lokjo të paça me jetë e me shëndet! Por dhe davaja pastë mbet si tha Leka!

[1]Jezerca ose Jezeri siç thirrej në popull

Prele Milani

Lindur për të nënshkruar akte heroizmi

NDOC PRENG LLESHI, MARTIRI, QË E PËRBUZI HESHTJEN -

Në jetën e përditshme aktet e heroizmit janë shoqëruese në ditët që jetojmë. Autorët e akteve të heroizmit mund të jene njerëz të zakonshëm që i kemi pranë dhe është e kuptueshme ti respektojmë. Por ka të tjerë, që nuk janë më në këtë botë të shqetësuar fund e krye. Janë martirizuar dhe kane kronikat e martirizimit. Disa nga këto kronika janë të plota. Kane mish e kocke. Janë bere flamuj e qëndrojnë në krye. Frymëzojnë here pas here, për tu përshëndetur sa here dalin në syprinën e ndodhive aq pak të zakonshme. Por ka kronika që mjerisht kane rene në vesh të shurdhër. Janë struktur në pelenat e heshtjes. Brezat në vijim nuk i kane kryer në kohe e siç duhen detyrat e shtëpisë.

Njëra nder historitë e shumta që shkëlqen me drite të pruar është ajo e djaloshtit Shkodran me origjinë nga Mirdita, Ndoc Preng Lleshi. Kjo histori është gërvishur krejt pak dhe vetëm në syprinë. U be subjekt e tri a katër mediave të shkruara dhe u dha një medalje dosido nga Kuvendi i Shqipërisë. Mund të thuhet pa ngurrim se akti heroik i Ndoc Preng Lleshit u strehua në hangarin e harresës kolektive. Nuk është mirë të largohet nga hambari i ndodhive kolektive një akt kaq heroik si ky i Ndoc Preng Lleshit. Pendesa ka lidhje me një tube njerëzore që neglizhohet ndodhinë aq të bujshme kur pluskojnë në ndërgjegjen kolektive të kohës, kur me drapër e çekan ndërtohet socializmi surreal e i padukshëm. Nuk është kurrë me vonese të rindërtohen kronikat për akte heroizmi si kjo e djaloshtit Shkodran, me origjinë nga Mirdita. Kjo edhe për faktin se ngjarje sublime si kjo e Ndocit ende sot dhe gjithë kohën rrezatojnë drite mirëkuptimi e bashkëjetese të shëndetshme.

Ja perse histori si kjo e Ndocit duhet kujtuar e ritreguar shpesh e më shpesh, pasi mendojmë se e temperon ndërgjegjen njerëzore.

Fjale zemre për një toprak që Meriton të qëndrojnë mbi përgun e mbijetesës

Për sa kohe shkrimi në adrese të Ndoc Preng Lleshit mban autorësinë time, nuk mund t'ju shmangem disa konsideratave për familjen e nderueme e të respektume të Lleshaj-ve, banore të kahershëm të qytetit të Shkodrës e me origjinë nga Mirdita.

Familja Lleshi njihet gjerësisht në Shkodër, Mirdite, Dukagjin e Malësi e Madhe. Një sozi të saj e gjen veçse kur ke bere një kërkim të konsiderueshëm. Njohja ime me këtë familje të bekume daton vitin e largët 1969, qyshkur unë si nxënës i klasës së peste mora mësimet e biologjisë nga mësuesi i atëhershëm Llesh Lleshi. Përveçse marrëdhëniet tona mësues nxënës ishin të natyrshme, njohja jone ishte intensive, në nivelin familjar.

Gëzimet e lajmmortet tona do të ishin të përbashkëta.

Preng Lleshi Shkurti, (siç e thërrasin trunqun e tij) kryetari i familjes, ishte një burrë me trup të lidhur, mustaqezi. Ato arinin në skajet e dy veshëve në tiparet e fytyrës të skalitura si me dorën mjeshtërore të Lin Delise. Ishte i qeshur, mikpritës e hokatar. Në vatrën e tij prite e përcillte miq e shoqe, familjare dhe të afërm, por edhe hallexhi, kishte një rit të veçantë në nderimin e miqve. I përcillte ata kur largoheshin, deri në rrugën e lagjes aty tek shkolla "Ndoc Mazi". Prenga ishte dhe mbetet miku im dhe i mbare fisit Bobnaj.



Ndoc Lleshi

Ai ndërroi jete në vitin 1993, kur engjëjt i dërguan ftese për një vizite në Parajse, shpirtit të tij.

Nene Mara ishte zonja e nderueme e shtëpisë. Ishte e bija e një dere të sojshme të Fushe Arrësit. Cilësitë fisnike të prindërve të saj i përcolli me dinjitet, në lagjen "Tre Heronjtë" e Shkodrës së madhe e të bukur. Nene Mara konsiderohej dhe vlerësohej dhe si pike referimi edhe për gratë intelektuale. Ndjenja e bamirësisë ishte e lindur dhe e kultivuar tek nena Mare. Ishte viti 2006 kur kjo nene e paharrueshme u largua nga kjo jete me shpellën brengje të humbjes së Ndocit, dritës së syve të saj.

Baca Preng e nena Mare linden e rriten 5 djem. Me i madhi nder to ishte Pashko Lleshi. Ky punoi për shume vite në Ndërmarrjen e Ndërtimit dhe më pas në atë të Parkut Automobilistik të Udhëtareve në qytetin e Shkodrës. Pashkoja ishte nder shërbëtorët më besnikë të bashkësisë në

Veriun e Shqipërisë Londineze. Pashko u nda me të tijtë vetëm fizikisht, dy vjet më pare duke lenë trëndafilin mos 'harrimit me bulëza vese përmbi te.

Djali i dyte i familjes ishte Zefi. Ishte metalurg i klasit të epërm. I zoti në profesion, por dhe i shkathet në jetën e përditshme.

Për Lleshin, vëllain e trete, kam shume për të thënë, por rezervohem disi, për të mos i lenë rast lexuesit me u shprehe se, çdo nxënës flet mire për mësuesin e vet. Kjo nuk do të thotë se mund ti shmangem ndonjë konsideratë të veçantë për mësues Lleshin. Në kohën kur shkruhet ky shkrim mësuesi im i kahershëm, Lleshi, mban në dore çelësat e tri familjeve me emër të Shkodrës. A nuk është kjo një dëshmi e besimit të Llesh Lleshit tregues i sinqeritetit të skajshëm që demonstron në përditëshmërinë e jetës së vet nga ai rrjedh?

Në radhe të brezit të djemve të Prenges e Mares, është Ndoci i paharrueshëm. Ne e thamë fjalën për këtë martir të lindur për të shpëtuar jete njerëzore. Natyrshëm ka vend të shkruhet e të shkruhet për aktin heroik të Ndocit, me përpjekje për të shpëtuar jetën e Pjerim Gemit, në fabrikën e Vajit të Ndërmarrjes Ushqimore të Shkodrës.

Gjasat janë të jete lenë për në fund dy a tri fjale të ngrohta zemre për Gjovalinin. Ky ushtroi profesionin e saldatorit në Uzinën Drini, për të vazhduar me vone në Ndërmarrjen Ushqimore ku u martirizua i vëllai. La peng profesionin që desh i aq shume, në korrikun e vitit 1990 me hapjen e ambasade. Saldatori me përvoje saldoi të ardhmen e vet në portat e mëdha të qytetërimit perëndimor në Gjermani.

Nuk besojmë se duhet shkruar më shume për këtë trung familjar fisnik në llojin e vet. Besoj se holla sadopak drite mbi toprakun ku u lind, u rrit e nënshkroi vepra heroike, Ndoc Preng Lleshi i Shkodrës e i Mirditës. Heshtja duhet trazuar nga njëra kohe në tjetrën, për ta shmangur sa të jete e mundur duhmën e moçalit.

Një shpelle në gjoksin tem

Njeriu që hedh drite në koracën e kësaj ndodhie intriguese, është një burrë me shikim të bute, fytyrë të skalitur hijshëm si të dardaneve kohanik me gjymtyrë që i lëvizin shpesh. Është vëllai i heroit protagonist, – Llesh Lleshi – dikur mësues në shumë fshatra të Dukagjinit e tash si një i moshuar që pak i gëzohet pensionit që merre.

Historia e vëllait të tij është një shpelle

në gjoksin tem,- shprehet Lleshi, – sa here endet jo pa kureshtje kjo ndodhi, plotësisht e denje për të nënshkruar një akt heroizmi. Ishim dhe jemi një qelize e dinjitetit shkodrane. Prindërit tanë Preng e Mare u kujdesen për të kultivuar tek Ndoci, që ishte nder të vegjlit e meshkujve të shtëpisë, me ndjenjën e solidaritetit dhe të sakrificës. Kjo përpjekje prindërore u kurorëzua më së miri sidomos në rastin e Ndocit. Ai për një mend nuk ishte thjesht model për tu ndjekur nga moshataret e tij, por shumë më tepër. Lleshi ka shumë episode për të treguar për vëllain, Ndocin. Ngul këmbë t'i thotë shpejt, por përpiqet ndërkohe t'jua heq pluhurin e gjate të harresës. I shkon mendja edhe tek qofte largu. Mos ka ndikuar laneti e ato episode nuk e kane shkëlqimin e dikurshëm? Kane kaluar pese dekada e vitet bëjnë punën e tyre. I ndryshkin trarët ku mbështeten. Nuk rrezatojnë si në kohën kur ndodhen këto ngjarje rreptësisht të trishtuara dhe sublime të cilat për brezin e sotëm e tejkalojnë imagjinatën.

Ndoci u lind në Shkodër me 5 Maj 1949. Ishte 29 vjeç kur me 25 janar 1978 dha jetën në vorbullën e mallkuar të solventit për të shpëtuar jetën e shokut të rinise e të punës, Pjerinin. Gazrat e tërbuara i patën jargët më të helmata se lëngu që mban në maje të buzëve nepërka, kur zhegu afrikan leh përtej limiteve të tij. Lleshi seç ka një pikëllim në zemër sa here e kujton ndodhinë rrëqethëse që tronditi dhe drithëroi qytetin mitik e të kahershëm. Pashuk Pjeter Gemi e Ndoc Preng Lleshi u martirizuan të dy të rrokur përgjithmonë, në emër të një ideali e dashurie të ndërsjellët. Ky mund të ishte akti i fundit që e karakterizoi Ndoc Lleshin, por jo i pari. Ai, i pari akt shembullor, dhe të tjerë që do ta pasonin kulmuan vite më pare, në rininë e hershme, duke nënshkruar sagën e heroizmeve të mëvonshëm e që shkëlqejnë në jetën plot kolorit të djaloshtit nga Shkodra.

Heroizma që përbufzin heshtjen

I rendit në një shkrim të tijin në shtypin e kohës. Gazeta "Zëri i Popullit" e datës 20 qershor të këtij viti e evidentoi këtë akt heroik. Dramaturgu, Fadil Kraja, – shkruan se – "një elektrikist nga Mirdita prej kah asht edhe Ndoc Preng Lleshi nuk lidhi thjesht dy tela në majën e shtyllës elektrike, por ndezi llambushkën e gëzimit festiv të një bashkësie të ngujuar në një kantier pyjor të largët. Një tjetër "Lleshi" djalosh prej Shkodre, jep jetën në këtë kohe, por për një tjetër motiv. Ai u përpoq me të gjitha forcat rinore të shpëtonte shokun e tij, Pjerrin nga mbyrtja e sigurte e avujve helmues të solventit në Fabrikën e Vajit të qytetit të Shkodrës. Akti i fillrojtësit u ndëshkua në Kane, në festivalin e filmit Evropian. Ku si "valle" sakrifiko-

het jeta e një njeriut për të lidhur dy tela? Aktin e Ndoc Prenges e pickoi heshtja, kjo ishte një rrëshqanore e sikletshme. E morën peng shtetarët e kohës. Ja vendosen lakun në qafe qysh kur gonxhoi si një lule mbi shkëmb. Heroizmin e Ndoc Prenges e përpiu heshtja e kjo nuk është normale dhe as njerëzorë për askënd”.

Vite më herët Ndoci gjendej në një piknik fundjave me shokët në brigjet e Gjadrit. Lumi ishte tërbuar. I pati tejkaluar vijat e kuqe. Në mesin e valëve të harlisura hetoi një njolle të murrme si qilimi fluturues në rastin e Aladinit të përrallës gjithë kolorite e muze. Dy vajza, 12 a 13 vjeçare patën marre turr drejt nofullave të llahtarshme të kaskades se hidrocentralit të Vaut të Dejës. Jeta e tyre ishte në fije të perit. Ndoci nuk priti. Nuk humbi as një të dhjetën e sekondës. U hodh midis valëve dhe i tërhoqi vajzat e mitura larg rrezikut të fundosjes në zgavrat e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Vaut të Dejës. Për këtë rast, ashtu si të tjerë raste, heshtja ishte e pranishme. E ftoftë si një logjike sharlatani. E pafytyre, sqepar që shkaktonte plage. Ndoci nuk e dëshironte heshtjen, nuk e meritonte. Ndaj nuk është vone të shkruhet dhe të flitet për këtë akt heroizmi e për të tjerë që kane ndodhur e ndodhin në vorbullat e kësaj jete me tallaze të zemëruara, me e pa shkumë.

Ndodh kështu, kur në krahun tjetër të balancës ndodhin shëmti të pariparueshme. Shkruhen libra e këndohen kënge për vrasësit, mashtruesit dhe...! E si mund të lihet në gjendje kome një ndodhi kur shoku jep jetën për një tjetër jete, atë të shokut që e konsideron mik e vëlla! Jeta vazhdon e kjo jete duhet të kërkoj strehe dhe për ata që heshtja e derisotme i ka mbuluar me pelerinën e vet të erret. Ata, që japin jete e bëjnë realitetin e jetuar më me shumë kolor dhe adrenaline. Ata, që marrin jete duhet të gjenden përballë sinjalit “SOS”, sepse ata e terratisin qiellin e jetës së përditshme. Shqipëria i ka sytë nga Evropa, në mos qofshim si komb as të qytetëruar, ani, mund të pajisemi më shpejt se u a merr mendja disave me atë letërnjoftim. Për Ndocin është shkruar, por jo aq sa duhet. Është sakrilegj të mendohet ndryshe. Në plejadën e heronjve dhe martireve duhet regjistruar nder të paret. E meritoi këtë vlerësim sepse kreu një tjetër akt të pashembullt në llojin e vet.

Vëllai që ngjit vëllanë në shtratin e një poeme

Patë thënë dikur Leonardo Da Vinçi: *“Ti që fle, thuajmë çka është gjumi? Gjumi i përngjan vdekjes. Atëherë perse nuk bën vepra në mënyrë që edhe kur të vdesësh t’i përngjash të gjallëve, ndërsa ti je i gjalle dhe i përgjigjesh të vdekurve të trishtuar”*. E ka menduar e tjerre holle këtë sentence të përsosur të mendimtarit nga gadishulli Apenin. Llesh Lleshi kur ka shkruar poemën për vëlla Ndocin, disa strofa të së cilës po i rreshtojmë në këtë shkrim pa pretendime të veçanta, por të dala nga thellësia e zemrës. Në këtë shkrim që rropatet t’i vere flaken heshtjes mizore që ngjall trishtim e shprese...

Nata është e ftoftë
era sikur t’pret
Nena i afrohet

shtratit t’ djalit t’ vet.
Ndoci mbi biçiklete
rrugën e përpin
gjoksin ja rreh era
por, ai nuk i`a din.
Me hov shkon Ndoci
tek pusi i solventit
Pjerinit, shokut të tij
i erret jeta të shkretit.
Për jetën e shokut
turret si shigjete
Ndoci nuk pyet
fundoset në pusete.
Por pusi i pabese
lëshon gaz pa pushim
Është vdekja që struket
është jeta që ka çmim.
Dy jete si lule bore
fiken krejt pahiri
Ndocin se kam ma
Gjalle s’është martiri.
Ndoc mos na harrove
vdekjen bere krushke
prindit dhe e fejuara jote
nuk duan tjetër pushke!
Me pas dite nana
se po shkon pa kthim.
Gjumin e Janarit
e tallte me durim.
Vitet ikin shpejt
të freskëta kujtimet
Prape në kujtese
mbeten vegimet.

Poema ka vargje pafund. Ato janë ende të freskëta, i bëjnë balle e sfide harresës. Ja perse shkruajmë e do të shkruajmë pafund për jetën dhe veprat që na la në kujtese Ndoc Preng Lleshi.

Vegime të qëmtuara nga dy shokët më të mire të Ndoc Lleshit

Ndoci pati shoke e miq të shumte. I pati në lagje shoke të fëmijërisë, por edhe shoke shkollë e pune. Me Ali Zjarrin e Muharrem Lezhën pati shoqëri të veçante. I lidhi te tre bashke vëllazërimi në lagje, në shkollën e Kuçovës dhe në punën e përditshme. Ja perse Aliu e Muharremi, në kohën kur Ndoci ishte ngjitur në qiell me ata krahë që ia qëndisen nena Mare e baba Prenge, përcollën kumte të ngrohta për shokun e tyre si vëlla, djalin e mirë, Ndocin.

Ishte shtator i vitit 1963, nis perceptimi ndijësor i një të kaluarë disi të largët nga ana e Ali Zjarrit e Muharrem Lezhës. Vit i ri shkollor zhvillohej edhe në Kuçove. Qyteti kishte veshur petkat e festes. Gjallëria ndihej kudo. Në fytyrat e qeshura të prindërve dhe të nxënësve. Ndoci, por edhe ne të dy, Aliu dhe Muharremi, gëzoheshim me gjithë shpirt, sepse gjendeshim midis njerëzve që motiv të jetës patën naftë “Ari e zi” ata e nxirrnin nga thellësitë e nëntokës dhe e përcillnin në furrat ku nafta behej e pastër e domosdoshme dhe e dobishme. Muharrem Lezha thotë se, u njoha me Ndocin dhe Aliun në Kuçove, në bankat e shkollës së mesme që emërtohej, “Teknikumi i Naftës”. Amanet Ndocin, i thotë nen Mara para nisjes së djemve tek stacioni i autobusëve të Shkodrës. Dhe pa e tjerre më holle bisedën, ata thonë se ishin shoke të një banke, të një klase dhe të një shkollë. Studionin në degën e Elektromekanikes dhe për kornizën e viteve të shkollimit,

Ndoc Preng Lleshi skicohej si nxënës i zellshëm e djalosh i shkathet si shpuza. Shkrimi që po e bëjmë teme të kësaj “qëndisjeje” nuk e duron hallakatjen. Pra le të futemi “brazde” për të treguar heroizmin e një dite aspak te rëndomte e të zakonshme. Kishin shpërthyer tubat e naftës në Kuçove. Ishte dhënë sinjali “SOS” për të gjithë banoret e qytetit të vogël, por simpatik dhe të këndshëm. Qyteti fundepërmasje miklonte thirrje, sirena e turma të pafundme njerëzish. Vorbulla e zjarrit fluturonte. Ajo i ngjante një kërpudhe të shpërfytyruar. Buldozerët si të ishin rinoceront, mësynin furrat që nxirrnin papushim naftë në sipërfaqe. Pirgjet e naftës gjendeshin mes flakëve në zemër të qytetit të vogël, por edhe në periferitë e tij. Thirrja që dëgjohej ishte kushtrim për naftën. Të shpëtohet “Ari e Zi”, ngulte këmbë gjallërimi kolektiv njerëzor. Ndoc Preng Lleshi ishte në gatishmëri për të kryer aktin sublim. Sipas tij, prona e përbashkët që ishte e shtrenjtë si floriri duhej mbrojtur ndoshta edhe me gjak zemrash. Drejte teknikumaseve ishte nisur me ngut një rreke naftë që shoqërohej nga një vorbull zjarri. Rrëkeja duhej ndalur e vorbulla e zjarrit duhej izoluar. Shoke mos bëni sehir, lëvizni me shpejtësi.- ishte thirrja e Ndocit, i cili u gjend në ballinën e turmës njerëzore. Shokët e kane ende në memorie edhe pse po shënohet largësia e pese dekadave. Ndocin energjik, trupgjate e muskuloz me vështrim të ngrohte miqësor e shpresëdhënës. Trupi i tij ishte qëndisur, e vezullonte me djerse dhe me naftë. Thirrjet e Ndocit injektonin optimizëm, siguri e shprese. Çasti më tragjik pasoj thirrjen e drejtuesit të turmës. Tubat e naftës u izoluan, u dëgjua zëri i tij. Po ku janë Myrtezai e Muhamedi? Në subkoshiencen e ndokujt zëri ishte edhe për të tjerë firmëtare të akteve të heroizmave nder mote. Perceptoj si me thënë ku është Mrika Tarazhi, Pjeter Llesh Doda, Shkurte Pal Vata, Ismet Sali Bruçaj, Isuf Plloçi e dhjetëra të tjerë heronj e heroina. Pra, më në fund tubat u izoluan, flaka mori fryme për here të fundit. Qyteti u rinua. Qeshi me gjithë shpirt. Por...! Ekzistonte edhe një rrisht vdekjeprurës. Ndoci turret ku rreziku është kanosës. Disa pika loti i rrëshqitën në faqe. Ishin qurgim lotësh me djerse dhe me naftë. Dhimbja tashme ishte krenare. Për shokët e dhomës dhe të klasës të teknikumit të naftës. Me gjithë rropatjet titanike të Ndoc Lleshit, Myrtezai e Muhameti mbeten midis flakëve, si flakadan në memorien kolektive. Ndoci kishte bere gjithçka munda, shokët pas atij akti të guximshëm shokët i thoshin se kishte lindur për të bere akte njerëzore, që e kane palce të veten heroizmin.

Shokët e afërt të Ndoc Lleshit nuk harrojnë të thonë se, ishin krenare që jetuan bashke me të katër vjet në Kuçove dhe vite të tjera në pune e shoqëri. Ali Zjarrin e Muharrem Lezha shkruajnë edhe për çastin tragjik kur u nis për në përjetësi, dhe përcjelljen e fundit nen breshërinë e artilerisë ky djalosh i Shkodërlocces dhe i gjithë Shqipërisë. Nuk kishte çfarë të jepte për shokun në rrezik jete Ndoc Lleshi, kur shoku i tij ishte midis jetës dhe vdekjes. Ndoci pëlqeu vetëflimimin e kjo është gjithçka mundet te beje njeriu


për të jetuar tjetri. Shokët e tij të punës e të jetës, nuk ngurrojnë të shprehen artistikisht se përball punëtorit më të mire të ndërmarrjes ushqimore të Shkodrës, ishte nata e erret dhe kuçedra. Ai i mundi te dyja. Jetën dhe vdekjen. Ndoci u dha për “matanë” tepër herët. E thërriti në qiell Zotëruesi i Parajsës, duke u nisur për atje pa ditur se, po nënshkruante përjetësinë. Ndoc Prenga ishte njeriu i duhur për të rilindur jete të tjera, i lindur për të fituar statusin e martirit, i lindur për të nënshkruar akte heroizmi e mbijetese. Mund të picigjatej ky kapitull rrethimi tejet i sinqerte, pasi janë disa zëra që presin të rrëfehen në emër të Ndoc Preng Lleshit.

U mjaftuam me tregimet e Ali Zjarrit e Muharrem Lezhës për t’jua lenë radhën miqve e shokëve të tjerë. Qëllimi është, që heshtja e verbër, që ka rene prej dekadash mbi këtë hero të të gjitha kohërave, të shkallmohet ose të behet shteg lehtësisht i depërtueshëm.

Flasin shokët për një shok

Jeta shoqërore e familjare ishte mjaft e gjere për Ndoc Lleshin dhe po e tille ishte për babën Prengë, një burrë tipik mirditor me mustaqe nga veshi në maje. Për nënëloken Mare, aq bujare e bukëdhëne sa e gjithë lagja “Tre Heroit” e thirrnin nena Mare, e cila ruajti me fanatizëm doket, zakonet dhe veshjen tradicionale të të pareve të saj. Për vëllezërit Pashkun e ndjere, për Zefin, Lleshin e më të voglin Gjovalinin dhe pjesëtarë të tjerë të fisit e gjakut të tij. Në vijim do të tregojmë historinë e kësaj familje sa të trishtë po kaq të lavdishme. Pjesën më të madhe të kohës ky hero i ditëve, që shkuan e për ditët që vijnë, e kalonte në punën e përditshme me shokët e profesionit të fabrikës së vajit, që ishte pjese e ndërmarrjes ushqimore të Shkodrës.

Shoke e miq, Ndoc Prenga pati shumë. Ata ishin dëshmitar aq here sa ky hero përpiqej me dallgët e jetës dhe nënshkruante akte heroizmi. Disa nga këta ishin edhe në Kuçove kur sfidonte flaket e zjarrit të shkaktuara nga shpërthimi pa kriter dhe i palavdishëm i naftës, që me të drejtën vlerësohej si “Ari e Zi” i Republikës së Shqipërisë. Ndonjëri prej tyre ishte edhe aty në breg të lumit Gjadër e përbalë me Malin e Veles, atje në fshatin Vig, që është truall Mirdite dhe heroizmi. Ata ishin me trup e me shpirt kur shoku i tyre Ndoc Lleshi dha shpirt në përpjekje për të shpëtuar jetën e Paulin Gemit. Shokët e tij e panë edhe kur u hodh midis valëve duke shpëtuar vajzat e mitura nga rreziku i fundosjes në zgavrat e portave të shkarkimit të Vau Dejësit. Disa nga shokët e tije ngritën në kënge heroizmin e pashoq të Ndocit. Vargjet e këngëve i ngjallnin emociione atyre që i dëgjonin. Këndohen edhe sot këngët kushtuar heroizmit të këtij dëshmorit të kohëve kur Shqipëria po hidhte shtat, e kur po kuronte plagët e marre nga lufta. Epoka e rindërtimit kishte nevojë për djem e burra, të cilët shpirtin e patën të ngjashëm me atë të Ndoc Preng Lleshit. Pati gra e vajza të shkathëta. Epoka e rindërtimit të Shqipërisë së vuajtur e të gëzuar ndërkohe. Disa nga vargjet e këngëve të lëndojnë kur i dëgjon. Por për mua si autor i këtij shkrimi për një gjë jam i sigurt, ato të shtojnë vullmin dhe entuziazmin për të vështruar më larg dhe për të



kemi thënë: “Gjella do kripe por kripa të jete e vetëmjaftueshme”.

Heshtja disi është grisur, por jo sa duhet për heroin e shkrimit tone

“PËR TRIMËRI CIVILE” është dekorata akorduar elektrikistit të ndërmarrjes ushqimore të qytetit të Shkodrës, e dhëne nga Presidium i Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë. Akorduar me 29 qershor 1978 dhe me nominim dekreti Nr. 5756. Kjo medalje është dëshmi se Ndoc Preng Lleshi “Me trimëri dha jetën e tij me date 26 janar 1978, në përpjekje për të shpëtuar shokun e punës, që ishte në rrezik, në fabrikën e ekstraksionit të vajit, në ndërmarrjen ushqimore të Shkodrës”. Haxhi Lleshi, kryetar i këtij forumi i lau duart si Pilati. Nënshkroi këtë dekret dhe kaq. Me autoritetin e vet ky shtetar i nivelit më të larte mund dhe duhej ta ndihmonte Prengë e Mara Lleshin.

Ai mund të urdhëronte ndërmarrjen për dëmshpërbim siç ishte vepruar në raste të ngjashme. Mund të bënte më tepër Haxhi Lleshi? Mund të nxiste administratën vendore minimumi për vendosjen e ndonjë pllake përkujtimore në lagjen “Skënderbej”, që është vendi ku u martirizua Ndoc Preng Lleshi. Ai dhe organet të tjera shtetërore dhe vendore mund të bënin më shumë se kaq. Vonë, pas një gjumi letargjik kujtohet Këshilli Bashkiak i qytetit të Shkodrës, për një *certifikatë mirënjohje*, për Ndoc Preng Lleshin. Është viti 2003, kur kjo certifikatë merr jete me firme të kryetarit të Këshillit Bashkiak dhe për ironi të fatit kjo certifikatë u rras në njërin nga sirtarët e këtij këshilli dhe u harrua duke u pluhurosur. Inteligjenca e njerëzve të zgjuar nuk shteron. Shkrimtari Fadil Kraja, tejet i revoltuar kundrejt këtij qëndrimi u drejtohet Kryetarit të Këshillit Bashkiak si dhe Kryetarit të Bashkisë

me date 21 Shkurt 2005 se, është në nderin e institucioneve, që ju drejtoni të shfrytëzoni ndonjë veprimtari për t’ia dorëzuar me ceremoni certifikatën e mirënjohjes dhëne Ndoc Preng Lleshit, familjareve të tij. Edhe ky qëndrim i lustron thënien e mençur të popullit tone “prit gomare sa të mbijë bare”. Kaq ishte nderimi për këtë hero apo dëshmor, quaje si të duash, o lexues i dashur i sakrificës njerëzore. Asgjë më shumë, asgjë më pak. Në asnjë përvjetor nuk u kujtua ky hero apo dëshmor i nivelit më të epërm. Ndërkohe vitet qysh kur dha jetën në moshën e maturimit e kalojnë numrin e 43-të të viteve. Ndoc Lleshi është në lartësitë qiellore, duke gdhendur me durim sloganin sipas të cilit “heshtja nuk është hiç e dobishme, për të mos thënë vrastare me kulm e me themel”.

Ai nuk ka nevojë për heshtjen tone. Ne nuk kemi nevojë për britmën e tij! Ky shkrim, në vigjilje të një përvjetori të rastësishëm mbaron këtu. Pa shkruar fjalën e mbrame, le të dëshmojmë edhe një here se Ndoci u shkollua në Kucove e nisi pune në minieren e Gjogjanit të largët. Pati profesionin e elektrikistit dhe e ushtroi detyrën si më i miri. Qëndroi në ballinën e më të dalluarve të minierës. Ishte i komunikueshëm me shokët dhe i disiplinuar deri në puritanizëm. Shquhej për dëshirën për pune, sinqeritet dhe për parim të asketeve në galeritë e minierës. Ishte punëtor shembullor e aktivist ballor, propagandist e kontribuues. Ishte pionier i ecjes e përparimit, projektues e zbatues në nivelin e një inxhinieri të shkolluar në perëndim. Shkëlqeu në Kucove, Gjogjan, në Zadrimën malore, në fabrikën e Duhancingares dhe së fundmi në fabrikën e Vajit në Shkodër dhe jo vetëm. Me gjithë pluhurin e harresës shkëlqen edhe sot për heroizmin e treguar.

Akti, me plote dinjitet i sakrificës sublime të Ndoc Preng Lleshi duhet nderuar e vlerësuar. Heshtja është “mish i huaj në një trup të shëndetshëm”. Le ta leme në lumninë e saj heshtjen. Do ta kujtojmë

Ndoc Preng Lleshin, pasi akti i tij është motivim për të kryer vepra që janë në dobi të njerëzimit, për sot e për nesër. Harresa është kufiri ku nis mjegullimi i ditëve në sosje të vjeshtës me hejbet plote e për maje. Gjeneratat nuk kane nevojë për kohëra me mjegull, në mos rreken për të fshire gjurmët njerëzore, edhe kur këta kane shqisa e komunikojnë si jo më mirë.

E vogla gjyle, amaneti i anës gjakovare dhe një dëshmor i lirisë -në vend të epilogut!-

Bashkëshortet Mare dhe Prengë Lleshi, së bashku me dy djemtë e mitur, Pashkon dhe Zefin në fillim të viteve dyzet, emigruan në Kosovën martire, konkretisht në qytetin historik të Gjakovës. Atje, në familjen e Prend Bardhokut jetuan disa vite. Mikpritësi dhe bashkëshortja e tij Ana, kishin dy vajza moshatare me djemtë e Prenges.

ndërkohë, në familjen e Prend Bardhokut bie “rrufeja”. Ndahet nga kjo jete Ana, duke lenë jetime pa nene e në dore të fatit vajzën tre muajsh, Gjylen. Në gërhamat e fundit të jetës Ana, gjeti kohe t’i thotë Mares: - “Amanet Gjylen, po ta le në këtë jete e do ta kërkoj në jetën e pasosur”! Në këtë kohe, në Gjakove ku ishte zot shtëpie Prend Bardhoku, ndodh diçka që të konsiderohet vrastare, është tepër pak. Prendi pas një goditje të çastit, merr pushkën e gjate, tenton të vrase Gjylen, vetëm tre muajsh. Sa një rrahje qerpiku ishte koha, që kaloi kur Mara i hidhet në krahë Prendit dhe ia ndal turren për të mos ndodhur ngjarja e rende. Nene Mara shtriu gjoksin mbi djep dhe shpëtoi një jete njerëzore. Me një veprim si ky u mbrojti jeta e një fëmije tre muajsh e për më tepër u mbrojti Amaneti i Anës.

Gjyla u rrit nen përkujdesjen prindërore të nenës Mare. Sokolesha shkodrane tregoi të njëjtin kujdes e përkushtim si për Zefin e vet të një moshe, ata u rriten si vëllezërit sinameze. Neper duart e Mares së Preng Lleshit u rrit dhe motra më e madhe e Gjyles me Pashkon.

Hallet nuk kane të sosur aq kollaj. Shtëpia e Pengë Lleshit behet strehe e një militanti e patrioti të ardhur nga Shkodra. Quhej Teofik Canga, hero i lirisë e i sakrificave të shumta, e le në fatin e vet Prengën duke i thene, që pas perfundimit të luftes Antifashiste Nacional-Clirimtare, eja e piqu me mua në Shkoder a kudo tjetër në Shqiperine e lire! Më kerko me numrin tre (që ishte kodi i luftes).

Takimi i fundit i Preng Lleshit me Teofik Çangen ishte një ferr i vërtete. U panë drejtpërdrejt teksa hero i lirisë Teofiku po ekzekutohej. Litari në qafen e tij u tendos duke e pikëlluar përjetë sdrën dhe jetën e Preng Lleshit.

Kjo njohje me Teofikun, Prenges i kushtoi edhe burgun. E rëndësishme është se, Gjyla është gjalle sot e gjithë ditën. Ata qe e rriten nuk jetojnë më, por Familja Lleshi është aty e përsëri rrezaton kulture dhe humanizëm. Pas kësaj historie të trishtë sot, është lidhja e Gjyles mbi 70-vjecare me djemtë e Preng Lleshit, e kësisoj lidhje është zor të gjesh në ditët që po jetojmë.

MARK BOBNAJ,
Mjek Stomatolog e Studiues,
Shkodër, me 21. 01. 2021

regjistruar pune të mira. Vargjet e këtyre këngëve në më të shumtën e raste ishin metafora e sentenca, që i shërbejnë lëmit të komunikimit të përditshëm njerëzor. Po regjistrojmë në këtë shkrim përgjithësues disa nga këto vargje te ndjera:

Babe e nane e ndezin mallin kur nisin me fol për djalin !
Në Gjogjan të largët rron ky emër kush e kujton e ka për zemër.
Kur shoqet tona vala i mori Ndoc Lleshi në breg i nxori.
Si gjithmonë kudo i pari guximtar me gjak shqiptari.
Luftëtar i çdo beteje gjak i kuq i rrjedhtë n ‘deje!
Kane premtua zogitë e këtij malit Me ja kujtua emrin djalit!

Dëshira për të paraqitur për lexuesin e kësaj kronike vargje të tjera të qëmtuara për Ndoc Lleshin, nuk mungojnë. Por ne kemi bere një pakt me lexuesin teksta

LAMTUMIRË, O NJERIU I MIRË NDUE DODAJ!

Sa shumë shokë e miq, të afërm e dashamirë, njerëz në nevojë, kuadro e intelektualë të kategorive të ndryshme, këtej e matanë kufijve të Shqipërisë, pra në hapësirën mbarëshqiptare, madje, kudo ku ka shqiptar e flitet shqip si: në SHBA, Australi, Kanada, Evropë, Turqi e të tjera, me të cilët ka mbajtur lidhje të përhershme, të drejtpërdrejta, virtuale....., por të gjithë këta që përmenda nuk e dinë e nuk do ta besojnë se Njeriu i Madh, me Trup të Madh, me Zëmër të Madhe, me shpirt të pastër e energji pozitive... ndërroi jetë "pabesisht" më 03 Janar 2021, jo si rezultat i moshës, por i vrarë tinëzisht nga armiku i padukshëm COVID-19.

Ishte bashkëpunues e bashkëkohorë, pasi fryma dhe natyra e tij ishte e tillë e paqet, pasi pranonte argumentin e debatin konstruktiv, për të prodhuar ide e projekte progresive sa më të qarta e të realizueshme sa më shpejtë, njeri që të bënte për vete për të punuar me përkushtim.

Nduja ishte komunikues, elokuent, i fisshëm që sugjeronte dhe pranonte racionalitetin e pëlqyeshëm e reciprocitetin e ndërsjellët për palët, prandaj, ishte kërkues e këmbëngulës për të arritur me çdo mjet objektivin.

Ishte respektues e moderator i këndshëm, për çdo ngjarje, qofshin këto raste festash, gëzimesh, hidhërimesh, fatkeqësish, përvjetorë të ndryshme e të tjera.

Mundohej të merrte pjesë në panairë të ndryshme si: për teknologjinë, për teknikën, armatimin, komunikimin, të librit, hapje ekspozitash, apo në panairë e prodhimeve bujqësore, blegtorale e ushqimore, të hapura në zona e treva të ndryshme, duke i afirmuar edhe me pamje e komente konkrete.

Në Kosovë shkonte vazhdimisht për të respektuar çdo ngjarje të shënuar, për promovim ngjarjesh të Luftës Çlirimtare, të UÇK-së, të dëshmorëve e heronjve, të promovimit të shtatoreve të tyre, të akademive e ceremonive të shumëllojshme të zhvilluara për ngjarje e personalitete të ndryshme, por edhe duke marrë grupe personash e individësh të interesuar e kureshtarë, duke i çuar e shoqëruar në Kosovë, nëpër vende historike si Prekaz, Prizren, Gjakovë, Prishtinë.... Prevalë,.....

Çdo gjë donte ta reklamonte me foto të ndryshme, për mos thënë që, Ndue Dodaj, ishte i veçantë në këtë drejtim.

Për çdo ngjarje, Ndueja ishte super i kujdesshëm ku gjithçka e kishte të mbajtur e të arkivuar me kujdes e me kulturë, duke e postuar në kohën e duhur e duke e risjellë në kujtesë (memorie) në vijimësi, në bazë të databezave të hartuar e mbajtur për këto qëllime.

I njihte shumë mirë rregullat tradicionale në tërë hapësirën mbarëkombëtare shqiptare, duke i ndjekur e marrë pjesë në:

Festat tradicionale e festivalet e trevave të ndryshme si: ato të këngës popul-



lore, të bukurisë femërore në Bjeshkët e Malësisë, festat e plisave e të tjera. Ai jo vetëm që vinte e merrte pjesë, por i ndiqte me kënaqësi të veçantë..

Ishte këmbëngulës deri në fund për të përbushur çdo detyrë me rezultat pozitiv e nota maksimale. Këtë e kam ndjerë në punën e madhe, e të veçantë e të lodhshme për përzgjedhjen e personaliteteve më të spikatura të Misionarëve të Paqes si: Fadil Kraja në Shkodër, çifti Shtjefën e Gjyste Ivezaj në Tuz të Malit të Zi, Asllan Mazreki në Malishevë, Mullah Fetah Bekolli në Prizren, Mullah Xhevat Kryeziu në Malishevë, Ideal Qollaku në Prizren, e shumë e shumë të tjerë.

Merrte pjesë aktive në çdo promovim libri, ekspozite duke diskutuar ose përpiquej për të siguruar librat, kur për arsye të ndryshme nuk ishte i pranishëm.

Realizonte vizita pune e guida turistike kudo nëpër Shqipëri, Kosovë, Malin e Zi, e të tjera.

Ai ka qene ushtarak madhor në gradë e funksion, por në Kosovë e kishin "graduuar" dhe e thërrisnin kur komunikonin: "Gjeneral Ndueja" ose Gjeneral "Bashkim Kruja", siç e kishin pagëzuar në vendet perëndimorë, mërgimtarët që erdhën e u bënë pjesë në formacionet e UÇK-së për të luftuar e çliruar trojet shqiptare, Kosovën nga pushtuesi serbe.

Ishte njeri i paqet prandaj, ishte Misionar Paqe në vlerësimin maksimal për punë e kontribut, duke i dhënë Medaljen e Artë "Veprimtar i Ndriritur i Njerëzimit" më 8 dhjetor 2019, ditën e ditëlindjes tij.

Njeri me zëmër e shpirt të madh!

Njeri progresist e integrues!

Mendimet e tij i shprehte kudo, me kuraja e pa ndrojtje!

Nuk linte momente historike e data të shënuara mbarëkombëtare pa respektuar si: Besëlidhja e Lezhës, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Konferencën e Pezës, Kongresin e Përmetit, Ditën e Pavarësisë, Ditën e Çlirimit, datat e krijimit të brigadave në të dy anët e kufirit shqiptaro-shqiptar, e të tjera.

Njeri aktiv, pozitiv!

Nuk llogariten sa herë e mesa njerëz të ndryshëm ka vajtur në Prekaz, në varrez-



at e familjes Jashari e në Kompleksin Muzeal të Adem Jashari, me ushtarakë madhorë, gjeneralë deri dhe ish Ministrin e Mbrojtjes Kiço Mustaqe, ish Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë Veli Myftari e të tjerë, pensionist, invalid, personalitete të ndryshme si: Ish Ministren e Arsimit Tefta Cami, Xhevahir Spahiu, Moikom Zeqo, Pëllumb Xhufi, me shkolla të ndryshme, me miq e shokë, grupe folklorike, këngëtarë, rapsodë, e të tjerë

Atdhetar i madh, nuk kishte vend ku të kishte ndodhur një ngjarje, të ishte ngritur një lapidar, bust,

shtatore, përmendore, pllakate apo objekt tjetër kudo në hapësirën mbarëkombëtare e të mos bëheshin vizita e homazhe si në Prizren tek shtëpia muze e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku Parim Kosova, Drejtori i Muzeut shpjegonte me pasion e saktësi gjithçka për Lidhjen Shqiptarë, qytetin e Prizrenit, Në Prekaz, ku i nderuari Rifat Bejta, ciceroni, derisa ndërroi jetë nuk u largua duke krijuar, formësuar, konsoliduar e fuqizuar Kompleksin Muzeal, të shpjegonte me tërë madhësi luftën titanike për çlirimin e Kosovës, ku mbi 20 milionë njerëz kishin vizituar këtë Muzeum. Në këtë vend, Ndueja kishte çuar edhe prindërit e tij dhe vet ka shkuar me uniformën ushtarake të Ushtrisë Shqiptare, duke nderuar e bërë homazhe në varrezat e familjes së Jasharajve.

Ndueja ishte një njeri human e solidar, që mundohej të ndihmonte njerëzit në nevojë me çdo mjet e me çdo formë, për mos thënë që ai e ngriti në një stad më të lart respektimin ndaj personaliteteve të mëdhenj si: Për të përgjithësuar shembullin e njeriut të madh, të Misionarit, të pajtimit të gjaqeve në Kosovë, Anton Çeta, mori nismën dhe e realizoi ngritjen e shtatores së tij në Rrëshen, Mirditë vendin e origjinës dhe të vlerave për të dhënë mesazhin e pajtimit dhe të bashkëjetesës. Po kështu punoi për vendosjen e bustit të Hillari Klinton në Sarandë, Richard Holbrook në Fier, e të tjera

Habia që shkaktoi vdekja e papritur e Ndue Dodaj, nga disa shokë, ja si e përshkruajnë:

Dr. Shefki Hysa Guvernator i DMPP

shkruan: "NDUE DODAJ-ENGJËLL I ZOTIT (Ndue Dodaj-Angel of God!...): Misionari i Paqes, Veprimtari i Ndriritur i Njerëzimit, Ushtaraku i Lartë Ndue Dodaj, Pilot Ushtarak Karriere Shqiptar, na la papritur plot hidhërim e dhimbje, duke iu bashkuar Armatës së Madhe të Engjëjve të Zotit! Diplomatik Misionar Peace and Prosperity (DMPP) dhe Global Peace Library ngushëllojnë familjarët, të afërmit, miqtë e gjithë dashamirët!...Iu prehtë shpirti në paqe! Qoftë i Parajsës!"

Ismet Sylejmani, NJERIU ME KONTRIBUTE TË SHQUARAATDHETARE shkruan: "I PAVDEKSHËM ËSHTË NDUE DODAJ! Është ndalur zëmra e madhe e birit të Krahinës famëmadhe të Mirditës, Ndue Dodaj! Kraharori i shqiptarit të madh, shqiponjës së hekurt të qiellit shqiptar, kolonelit të aviacionit ushtarak të Shqipërisë Ndue Dodaj, nuk frymon më! Mbyll sytë Ndue Dodaj, embleme e madhe e Mirditorit progresiv e integrues brenda hapësirës gjithëshqiptare! Ndahet nga jeta shoku, vëllai e miku im i veçantë, i pavdekshmi Ndue Dodaj! Moment i rëndë dhe i dhembshëm për Babain Gjon Nikolli, për bashkëshorten, fëmijët, nipat e mbesat, vëllezërit dhe motrat, për familjen e ngushtë dhe të gjere të Dodaj, fisin, shokët dhe miqtë e shumtë të të paharruarit Ndue Dodaj! Ngushëllime familjes Dodaj, të gjithëve që e kanë dashur, që e kanë nderuar dhe që e kanë njohur të pashembulltin, njeriun e madh e të mirë dhe të përkushtuar të çështjes kombëtare, atdhetarin dhe patriotin e shquar Ndue Dodaj! Prishtinë, më 03 Janar 2021!"

Nazmi Çela, shoku mbi gjysme shekulli, misionar i Paqes shkruan: "NDAHET NGA JETA NDUE DODAJ! E pabesueshme, por e vërtetë shumë e hidhur, që burrin e madh, njeriun me peshë të rëndë e zëmër të madhe, e goditi poshtërsisht armiku i padukshëm Covid-19, për mos u ngritur më në këmbë, Ndue Gjon Dodaj. I madhi Ndue Dodaj, nuk i trembej asgjëje, madje edhe luftës duke kontribuar direkt në çlirimin e Kosovës nga pushtimi serb, në afirmimin e vlerave të UÇK-së deri dhe në ngjarjet që bëheshin për luftëtarë e heronj këtej e matan kufirit. Nduja ishte një shqiptar që i dhimbte shpirti për bashkimin e trojeve shqiptare. Nduja ishte një Misionar Paqe i përmasave Globale duke punuar papërtuar kudo në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Malin e Zi, e të tjera. Nduja ishte kuadër që shikonte e mendonte shumë larg. Ishte njeri që respektonte punët e mira. Nduja ishte i papërtueshëm për të përbushur cilësisht çdo detyrë e pamarre parasysh vështirësitë dhe kostot e saj. Habitem si të mori ty shokut e vëllait tonë kjo sëmundje tinëzare me gjithë atë vitalitet e forcë që kishit ju. Po ndahesh fizikisht, por shpirtërisht jo!"

Zalo Hysi, ish Major në Aviacionin Fluturues në Farkë shkruan: "Një humbje e madhe, sot për Mirditën, Aviacionin dhe Kosovën. Në hidhërim të thellë na la Patrioti, BAC NDUE DODAJ. Ngushëllime të singerta Familjes!"

Gjin Musa, ish kuadër në Aviacion, Farkë shkruan: "Nuk dua të besoj këtë lajm! Ky kolos të jetë shuar? Jo, jo shqiponjat nuk shuhen, ato fluturojnë drejt qiellit, po, po shpirti i këtij fisniku do të jetë gjithmonë lart në qi-

ATË LUIGJI PALAJ ATDHETAR E MARTIR I KISHËS

- Nga vetmia e maleve të Dukagjinit fatos i Kishës dhe atdheut -

Në Ashtën pa anë të plot lisa të Kishës Katolike. Në vargun e gjatë të maturve që u flajuan nder kohëra i përndritur nga drita e amshuar është emri At Luigj Palaj. Ai lindi në Janjevë më 21 shkurt 1878 dioqeza e Shkupit-Qe biri i Tomës dhe i Paulinës pagëzuan me emrin Mati. Dukagjinan nga fshati Palajt e Shllakut i shpërngulur në Kosovë për arsye hasmërie. Disa dekada më vonë ky fshat i vogël struktur mes malesh do ti dhuronte kishës një tjetër martir dhe kulturës shqiptare bletën e visareve kombëtare At Benardin Palajn. Matia që vogël u thirr nga Zoti për rrugën rregulltare në radhët e fretërve të vegjël françeskanë. Studioi në Shkodër, Troshan e Itali, ku më 23 shtator 1896 veshi zhgunin e Shën Françeskut. Kushtet e përkohshme i bëri më 23 shtator 1897, të përjetshmet, më 8 dhjetor 1901. Mbas krenimit të Meshës së parë, më 20 prill 1903, nisi misionin si bari i shpirtave në Baz, 10 orë larg Lezhës, e njëkohësisht mblodhi lëndën që i nevojitej për ndërtimin e Kishës së re në fshatin Glllogjan.

Pas shugurimit meshtarak (në Zym të Hasit, më 20 prill 1903), në Romë kreu studimet pasuniversitare. Gjatë viteve 1905-1907 shërbeu famullitar në Arqipeshkvni-në e Shkodrës. Më pas kaloi në Gjakovë (1907-1912) ku ishte emëruar rektor i shenjtorit Shën Antonit, e më vonë shërbeu në famullinë e Pejës dhe të Glllogjanit të Lugut të Baranit.

Në vazhden ekspansionit agresiv malazez në trojet e okupuara shqiptare, Atë Luigj Palaj i pa dëshiruar si shqiptare dhe patriot i flakërishtëm u mor në shënjestër dhe u arrestua vetë i gjashtëdhjetë. Akuzohej gjoja për zhvillimin e propagandës në popull për mosdorëzimin e armëve dhe për t'u ngritur kundër malazezve. Burrë trim i vendosur në besim dhe atdhetari, i kulturuar me edukate perëndimore dhe i pajisur me virtutet më të lara njerëzore të kohës. Si meshtarë i Kishës së Glllogjanit në Lugun e Baranit – Atë Luigj Palaj, vazhdimisht qëndroi në mesin e grigjës së tij, duke i forcuar shpirtërisht dhe duke iu dhënë zemër që t'i përballojnë torturat e pushtuesit serbo-

malazezë për t'i qëndruar besnikë fesë dhe kombit të të parëve.

Pasi e keqtrajtoi në mënyrë shtazore (më 5-6 mars 1913) përfundoi në burgun e Gjakovës. Qëndroi, sfidoi me neveri përbuzjet, fyerjet dhe poshtërimet. Kur nuk e ligështuan, me dhunë e vunë përpara me të tjerët, të lidhur dhe e nisën për në Pejë. Gjatë rrugës, në Janosh të Novasellës së Gjakovës, e ndanë nga grupi vetë të shtatin, ia zhveshën zhgunin e fratit dhe e detyruan



të ecte zbatuar nëpër acar të madh, derisa "pendohej për "pauhdësitë" e tij anti sllave. Atë Luigji qëndroi si shkëmbi mes valëve. I kërkuan të bënte kryq në tre vende dhe refuzoj më qetësi. Të egërsuar deri në verbëri nga instinktët satanike ju vërsulën ta thyenin me prerjen e dy gishtërinjve të dorës së djathtë, që të mos mund të kryqohej me pesë gishtërinjte, siç kryqohen besimtarët katolik, por vetëm me tre, siç kryqohen besimtarët ortodoks.

Pas krejt atyre torturave, xhelatët ia morën shpirtin duke e masakruar me bajoneta, e në anën tjetër autoritetet malaziasë njoftonin se "kriminelin" Atë Luigj Palaj kishte provuar të ikte. Këso shpjegimesh jepeshin për të gjithë shqiptarët e burgosur në mënyrë që të kishin pretext që t'i vrisnin. Vjena dhe legata austro-hungareze në Ceti-

në, të informuar nga nënkonsulli i Prizrenit, Fiberio Pecel, kishin njoftuar menjëherë për vrasjen e meshtarit françeskan. Lajmi ishte përhap shpejt në qarqet diplomatike dhe kishte zënë vend në krye të faqeve të shtypit austriak, gjerman dhe anglez. Gazeta "Neue Freie Presse" e Vjenës theksonte se vrasja e klerikut katolik dhe konvertimi i shqiptarëve në ortodokësimin sllav, ishte edhe një provë e re e krimeve serbo-malaziasë mbi popullin shqiptar. Pasuan demarshet diplomatike të fuqive të mëdha dhe hapat energjik të Austro-Hungarisë, demarshet këto që mbështeteshin në të drejtën e shqiptarëve të besimit katolik në protektoratin kulturor, të siguruar pas luftërave me Perandorinë Osmane, që i referohej vendimeve të Kongresit të Berlinit, që e obligonte edhe Malin e Zi t'i respektonte ndjenjat fetare në viset e okupuara shqiptare. Së këndejmi, me notën e parë që Vjena ia dorëzoi Cetinës, tërhiqte vërejtjen se vrasja e klerikut Palaj kishte ndezur indinjatë të madhe në popull, përkatësisht të shqiptarët e besimit katolik e mysliman, dhe në të njëjtën kohë kërkoheshin zhvillimi i hetimeve rreth burgosjes dhe vrasjes së Atë Luigj Palajt. Me notën e dytë Austro-Hungaria kërkonte nga Mali i Zi rikthimin e menjëhershëm të shqiptarëve katolikë në fenë e mëparshme, duke ua bërë me dije se hetimet do t'i zhvillonte arqipeshkvi i Prizrenit, imzot Lazër Mjeda, i shoqëruar nga nënkonsulli i atjeshëm austriak.

Sado që pala malazeze e ngushtoi punën e Komisionit të hetimeve vetëm në shqyrtimin e vrasjes së Atë Luigjit, katër persona që ishin me të, e të cilët i shpëtuan pushkatimit, ishin të burgosur, kështu që nuk mund të dëshmonin të vërtetën. Dhe ajo ishte së frati i Glllogjanit – Atë Luigj Palaj as që provoi të ikte, as që u vra me pushkë, si thuhej në raportin zyrtar malazias. Kur trupi i tij u nxor nga varri, doli se ishte masakruar me bajonetë. Dhe, meqë pala malazeze e Komisionit këmbëngulte në versionin e saj të vrasjes, përkatësisht në ekspertizën e dy mjekëve malazezë dhe të një mjeku serb, nënkonsulli Pecel u largua nga Gjakova në shenjë proteste. Nga ana e saj, qeveria austro-hungareze kërkoi për

katolikët shqiptar nga pala malazeze – pos tjerash edhe të drejtën e zgjedhjes së lirë të vendbanimit. Cetina, ndërkaq, u përgjigj me cinizëm se katolicizmi ishte i mbrojtur me ligjet e Malit të Zi. Megjithatë, imzot Lazër Mjeda nuk dëshironte t'u jepeshin disa të drejta vetëm shqiptarëve të besimit katolik, por ai kërkonte që të mbrohen të gjithë shqiptarët pa dallim besimi. Puna shkoi deri aty sa malazezet gati e kishin ndarë mendjen ta vrisnin edhe arqipeshkvin Mjeda me dorën e ndonjë shqiptari... Selia e shenjtë, me propozim të Konferencës Ipeshkvore e Shqipërisë, Atë Luigj Palaj shpallur Martir të Kishës Katolike. Me 12 qershor 2012, Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e dekoron me dekoratën "URDHRI I LIRISË", për kontributin e lartë për liri të Kosovës.

Ipeshkëvia e Kosovës në shenjë nderimi të Atë Luigj Palajt, në vitin 2011 ngriti në Janosh Kishën që iu kushtua Atë Luigjit. Kisha u ngrit pikërisht aty ku edhe ishte ekzekutuar Atë Luigji, përkatësisht aty ku edhe që nga vrasja e tij gjendet i vendosur një Kryq i Madh.

Nga shpirti i lënduar buroi një elegji fishtjane për fatosin e pa epur

1 Barbarët... e mbyten! E pra
Ky 'i dhunë kurrkuj s'ia bani;
Nuk bëni kand me kja:
Për t'keq s'i duel kurr zani;
Për Atme e shenjtën Fé/
Punoj me t'drejtë m'ket dhé./

I vorfni pa prind mbetun,
Qi kjan, për bukë i mjeri,
(Te ky shujtën pat gjetun;
Ky lott prej sysh i a teri,
S'e la nen dhunë me fshâ/
E át e māmë iu bâ...

At Luigj Pala është nga shembujt më kuptimplotë të një martiri që për Shqipëri dhe besimin në Zot nuk njohu vuajtjet, dhimbjet fizike, as frikën e vdekjes për ideale më arta njerëzore

Prele Milani

ell, do na përshëndes në jetë të jetëve. Lavdi të përjetshme, ike para kohe.....Lamtumirë të thotë armata, lamtumirë të thotë Mirdita, lamtumirë shokët e jetës. NDUE DODAJ jeton në ALTARIN E PAVDKËSISË".

Sanije Rexha, bashkëluftëtarja e bashkëshortja e Heroit Kombëtar Abedin Rexha me pseudonimin "Sandokani", shkruan: "Paska ikur nga kjo botë njeriu që mund të them pa ndrojtje dhe me pikëllim të thellë më mbështetësi, më udhërrëfyesi, më miku, më vëllai, dhe si prind i imi, Ndue Dodaj! Sa herë që kisha pikëpyetje për ndonjë problem enigmatikë, Ndue Dodaj ishte udhëzuesi më i mirë për të ju shmangur të keqes si këndej dhe anëj shtetit amë, nga individë të qarqeve të ish pushtuesve. Më goditi vdekja e tij e papritur, ashtu siç goditet bija për ikjen e prindit. (Piloti i kohës së Enver Hoxhës i shkruante letër ish luftëtares së UÇK-së që mori Medaljen "Shotë Galica" (bashkëluftëtarja e bashkëshortja e heroit kom-

bëtar Abedin Rexha – Sandokani)"

Rita Kalaj Shkurti, intelektuale e Misionare e Paqes shkruan: "Shënonte data 8 dhjetor 2019, ku kjo ceremoni përkonte edhe me ditëlindjen e z. Ndue Dodaj gjë e cila nuk kaloi pa vëmendje, pasi Misioni Diplomatik i kishte përgatitur edhe një vlerësim enkas për këtë ditë, duke i akorduar Medaljen e Artë si Veprimtar i Shquar i Njerizimit, si dhe Diplomën e Nderit nga OKB, të miratuara nga të gjitha Organizmat Diplomatike Botërore Bashkëpunuese e të firmosura nga Prof. Dr. Madhu Krishan, Kryetar i Akademisë Botërore të Paqes. (Gazeta Dukagjini). Ngushëllim familjes, shokëve e miqve të tij! Kujtimi i tij mbetet në gjurmët dhe veprat e mira që la pas! Ishte me të vërtetë një misionar i denjë paqeje ndaj shpirtit të tij pushoftë në paqe në mbretërinë qiellore!"

Dr. Sulejman Abazi, ish ushtarak i lartë e Misionar Paqe shkruan: "Ngushëllime familjarëve, miqve e shokëve. Një

ikje kaq e papritur që ka lënë në hidhërim të gjithë ata që e njohën e bashkëpunuan me këtë njeri të mirë, me shpirt paqësor, një profesionist i Forcave të Armatosura, një familjar i përkushtuar, njeriu dinamik që dha kontribute shumë të çmuara në lëvizjen kombëtare, në mbështetje të Luftës Çlirimtare të UÇK-së. Njeriu solidar dhe human që u qëndroi afër familjeve të lënduara, njerëzve në nevojë. Aktivisti i palodhur në rrugën e Paqes, një mik i afërt dhe mbështetës i misionit fisnik të DMPP. Lamtumirë o njeri i mirë! Paç rrugën e Zotit në Parajsë! Pushofsh në Paqe! Lamtumirë!"

Dr. Kristo Goçi, Misionar Paqe shkruan: "Ndue, o njeriu i paqes, njeri i mirë! Si u largove kështu, heshtur e pa bujë. Gjithsesi shpirti juaj i bukur qëndron këtu mes nesh, miqve dhe familjarëve të tu. Mbetesh i paharruar o mik i dashur...!"

Ndërsa Kolonel Ndue Sanaj ish ushtarak madhor shkruan: "Lajm i trishtë për mikun e kolegun tim Ndue Dodaj. Më vjen

shumë keq, për ndarjen nga jeta të këtij burri kudo gjendur njerëzve sa më afër në nevojë për t'i ndihmuar.....".

Pra, shokim largimi i papritur i këtij njeriu e personaliteti progresist e integruar me shpirt të madh human, atdhetar i flaktë i përmasave mbarë kombëtare që i dhembte shpirti për bashkimin e trojeve shqiptare e kudo që dëgjohej e flitej gjuhë amtare, hidhëroi me qindra e mijëra njerëz të të gjitha kategorive e niveleve për vlerat që përmbante e manifestonte kudo në çdo mjedis e misionin që kishte është një obligim shoqëror e shpirtëror për të përfunduar ato detyra e për të mos harruar punët e mira të nisura.

Le ta kujtojmë e të lartësojmë ketë shembull pozitivë që kanë qene pjesë integrale e shoqërisë tonë të shëndetshme.

Nazmi ÇELA, Misionar Paqe,
Tiranë 14 Janar 2012

U KËPUT NJË MRIZË RA NDOC GRIMAJ, SHKOJ NË AMSHIM

U largua për në amshim edhe Ndoc Grimaj. Familja, të afërmit, shoqëria, Lotajt, Dukagjini, Shkodra por edhe më gjerë po ndahen nga ky burrë shembull për pamje, për shkollë, për mend, dashurues i traditave më të mira krahinore e shqiptare, por dhe dashurues i bashkëkohores. Kosa e vdekjes na e mori Ndocin. U këput e ra edhe një mrizë në Lotaj e Dukagjin.

Ndoc Grimaj u lind në fshatin Lotaj të Shalës. Ishte djali i dytë i Grim Biceleit dhe Lulë Sadikes, bijë e Nicajve të Shalës. Djali i parë dhe fëmija i madh i këtij çifti është Prelë Grimaj, maturanti i parë dukagjinasi pas çlirimit, i pari universitar dhe pedagog dukagjinasi në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, sot Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", "Qytetar Nderi" i Shalës dhe i Rrethinave, si edukator i brezit të ri, e sidomos si drejtues i aksionit kombëtar për zhdukjen e analfabetizimit në Dukagjin. Prelë Grimaj u nda nga jeta para dy vitesh.

Ndoc Grimaj ishte i përkushtuar maksimalisht në dashurinë për vendlindjen e tij. Ja si shkruan në disa shënime për Lotajt dhe banorët e tij. "Dashuria dhe respekti i pakufishëm për vendlindjen time, Lotajt e Shalës, burojnë jo vetëm nga bukuria e atij vendit, me atë reliev disi të ashpër, por shumë të bukur, i cili fillon nga Kodra e Shkafit e Porta e Shalës deri në Kodërshëngjergj, e nga Lumi i Shalës e deri në bjeshkë ku zotëron Suka e Kunorës, por kryesisht për bukurinë fizike e shpirtërore të banorëve të tij, për ata burra të urtë e trima sa herë e kërkonte nevoja e fshatit, zonës e krahinës, të cilët vetë Shala i quajti "Djemtë e Lotajve", për ato gra fisnike që lindën dhe rritën këta djem, për bijat tona, të cilat, atje ku shkuan, çuan ndër e burri, e lindën dhe rritën djem, nipat tonë, shembullorë të mirë në tërë Dukagjinin. Natyrisht, në Lotajt, jemi krenarë dhe mirënjohës për Shalën e Dukagjinin që na kanë vlerësuar e respektuar".

Pas 16 vjetëve martesë, vdes Grim Biceleit, la bashkëshorten në kushte shumë të vështira me tre jetima, sepse patën edhe



një vajzë e cila ka vdekur pak kohë pas babës vet, në gjendje shumë të rënduar ekonomike.

I mbeti Lulë Sadikes të jenë edhe zot edhe zojë shtëpie. Shteti i asaj kohe, për të ndihmuar këtë familje, djalin e madh Prelën, e dergoi me bursë në Shkollën Pedagogjike në Elbasan, të cilën e mbaroj me rezultate të shkëlqyera në vitin 1954. U regjistrua, kështu, edhe maturanti i parë dukagjinasi. Gjatë kësaj periudhe, Lula me djalin e vogël, Ndocin, kaloi një jetë shumë të vështirë, me halle e me mjerim të madh. Në këto kushte jetese ajo provoi forcën dhe karakterin e saj, por provoi edhe përkrahjen e ndihmën e madhe të fshatit që për të mbeti e paharruar deri në vdekje. Prela sa mbaroi shkollën u emërua mësues dhe pak më vonë drejtor në shkollën 7 vjeçare në Breglumi Shalë, pasi për ti ardhur në ndihmë familjes, refuzoi bursën për studime të larta në Moskë. Këtu filloi të ndryshoi gjithçka në jetën e familjes Grimaj. Ndoci fillon shkollën e mesme pedagogjike në Tiranë në vitin 1955, çka shënon edhe largimin e tyre përfundimtar nga Lotajt. Pesë vjet në Breglumi, dy në Theth dhe prej vitit

1963 u transferuan në qytetin Shkodër. "Nëna jonë, shkruan Ndoci, na futi në gjak dashurinë e thellë për fshatin, për njerëzit e mirë të tij, për burrat e gratë, të cilat për shtat vjet i dhanë ndihmë e përkrahje të jashtëzakonshme familjes tonë. Këtë dashuri e respekt ajo e tregoi deri në fund të jetës së saj. Ishte kjo arsyeja që ajo e kishte ëndërr për të qenë edhe e vdekur atje, në mes të atyre njerëzve të mrekullueshëm. Këtë dëshirë të saj ne ia plotësuam, kur bëmë rivarrimin e saj në varrezat e fshatit Lotaj, në Kodër të Shkafit".

Ju mungoi zëri dhe mësimet e babës, Ndoc, sepse ai vdiq në moshë të re dhe ju u la të vegjël, por patët mësimet e nënës tuaj sojnikë ku u lind dhe ku u martua, nuk të munguan as këshillat e të afërmeve dhe dashamirëve. Por shpejt u bë i aftë për të dhënë këshilla e mësimet Prela që ishte shembull në të gjitha drejtimet për ty e çdo kenë që mund të kishte nevojë.

O Ndoc i dashtun! Krijimi i familjeve tuaja rriti vlerat dhe mundësinë për më mirë. Prela me Shkurten, dhe ti me Shaqen, bashkëmoshataren dhe shoqen time të shkollës 7 vjeçare, sepse u lidhet me familje të dalluara e të veçuara për mirë në gjithë krahinën. Fëmijët e të dy palëve janë nga më të mirët dhe fliten vetëm fjalë të mira kudo që kanë punuar dhe kudo ku punojnë dhe jetojnë.

Ju ishit dhe mbetet shembull i shkëlqyer në marrëdhëniet familjare e shoqërore, në shkollim dhe punë, për dashurinë për vendlindjen, zonën, krahinën dhe Shqipërinë. Kudo që punuat e jetuat e mbyllët me nder.

Ndoc i mirë, sot po largohesh nga kjo jetë, e po len prapa bashkëshorten, djemtë, mbesa e nipa të veçuar për mirë. Sot po ndahesh nga shoku i jetës, Shaqja, të cilën gjatë gjithë jetës tuaj bashkëshortore e ke pasur krahu të djathtë kudo e kurdo. Ajo është përpjekur vetëm për të mirën, nderin dhe vlerat tua dhe familjes tënde, gjë të cilën e ka arritur plotësisht.

O Ndoc Grimaj, u ndave nga kjo jetë në kohë shumë të vështirë, kur e kanë të

beu në qendër të Bardhajve ku fjalët e tij ishin gjithmonë të ëmbla, me një komunikim njerëzor ju shërbeu të gjithëve. Ishin banoret e rijtë të ardhur nga të gjitha skajet e Dukagjinit, të cilëve ju shërbente me ore të tera me një shembull të pa pare njerëzor.

Sëmundja e shekullit e mori para kohe duke lenë pas nënën Leze, tre fëmijë e bashkëshorten Mire, vëllezërit dhe motrën Angie. Vdekja e parakohshme pikëlloj shumë shokë e miq neper bote. Të gjithë bardhanjoret shprehën ngushëllime për këtë njeri me moral e shpirt të madhe.

Pushofsh në paqe shok im!

Të gjithë atyre që të njohën, me dhimbje do të kujtojmë për jete!

Zef Nika, Bruksel

NUK PRITE NDËRRIMIN E VITEVE SHOKU IM I KLASËS

Mësova me dhimbje të madhe se si shoku im i klasës iku pak ore para vitit të Ri.

Prej disa ditësh Tonini ishte shtruar në Spitalin e Shkodrës, i cili ishte i infektuar nga virusi Covid-19. Me gjithë përpjekjet e mëdha të personelit mjekësor e familjareve, virusi nuk e la të gëzonte ndërrimin e viteve.

Tonin Gjelo Doda lindi në fshatin Vile dhe prej aty do të transferohej e do të banonte në fshatin e sapo ndërtuar në 1967, në Vukjakaj-Gegaj, Shllak, ku ishte krijuar qendra e Kooperativës. Ishte familja e Gjelo Dodes, një familje me shumë fëmijë, te cilët u rriten me sakrificë e me moral të lartë. Një nder ta ishte dhe Tonin Doda.

Tonini merr arsimin e mesëm në shkollën e mesme bujqësore Shllak, i cili dallohej si nxënës shembullor dhe një njeri me sjellje shembullore në shoqëri.

Tonini nisi punën në klubin e Shllakut, që administrohej prej ndërmarrjes tregtare e të konsumit. Pas vitit 1990 Tonini transferohet për në Bardhaj. Po aty Tonini do të vijonte jetën përsëri në tregtimin e artikujve të ndryshëm. Nuk ka njeri në Bardhaj që nuk e njohu "po shkoj me blej te Tonini". Tonini prej shume vitesh shër-

vështirë, ndoshta edhe të pamundur për të parë familjarë e dashamirë për herë të fundit, për të hedhur një grusht dhe, por i qetë se ti i plotësive të gjitha detyrat tua personale, familjare dhe shoqërore.

Ne deshëm që jeta jote të ishte më e gjatë, sepse kishim dhe kemi nevojë për ty e njerëz si ti, për burra si ti, për edukator si ti, për mësimet dhe mençurinë tuaj të pakursyer, por vdekja e pamëshirshme të rrëmbu, të rrëmbu kjo sëmundje e pabesë e cila do të kujtohet historikisht shumë gjatë, duke lënë një shteg, një rogë të madhe hapur, por ke lënë dy djem soko-la që do të dinë të mbajnë me nderë emrin tënd, të plotësojnë si do të doje ti vendin tënd, në familje, në rrethin shoqëror, në punë e veprimtari të ndryshme, në takime e biseda, në tavolinë e kudo ku duhet të jenë.

Ti ishe një ndjekës dhe dashamirë i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" në veprimtaritë e saj dhe bashkëpunëtor i gazetës "Dukagjini". Shoqata humbi një dashamirë e bashkëpunëtor të pakursyer.

Ti ike nga kjo botë në këto ditë festash, u largove për në amshim pak orë pa trokitur Viti i Ri, e edhe për këtë do të kujtohesh shumë gjatë, nuk arrite të tokësh gotat e ti përshëndetje familjarët e tu që aq shumë janë të mërzhitur për ty, edhe nga ky largim do të kujtohesh me dhembshuri dhe dashuri e respekt.

Ti ike për në botën tjetër me fytyrën e pastër e kokën lart. Nuk e njollose asnjëherë detyrën e mësuesit që fillove punë për herë të parë, e as uniformën e ushtarakut të forcave të rendit deri në rangje madhore deri sa dole në pension. Për ty janë krenar e ballëlartë familja jote e shkëlqyer, bashkëshortja Shaqe, djemtë Iliri e Armiri, nipat e mbesat, janë të afërmit, shokët e shoqet e shumtë të familjes tuaj, janë Shala e Dukagjini, janë të gjitha ata që të njohën e punuan me ty. Jam unë dhe bashkëmoshatarët e mi që të patëm mësues dhe drejtor shkolle në fillim të viteve '60 në Theth, e nga ajo kohë asnjëherë nuk u ndamë, pavarësisht arsyeve të punës, por ishim shumë afër me mendje dhe zemër.

Lamtumirë Ndoci ynë i mirë!

Pushofsh në paqe!

I bekuar qoftë dheu që do të të mbajë!

Luigj Shyti



HISTORIA E LEZHËS NDËR SHEKUJ



nga Profesor Gjon Frani Ivezaj

Qyteti antik i Lezhës cilësohet me emrin Lissitan. Janë bere disa zbrëthime etimologjike deri më sot nga dijetarë të ndryshëm. Është përngjasuar emri Lezhë, apo Liss me fjalën shqipe Lis çka përbën një etimologji popullore. Ka të tjerë që emrin Lezhë e lidhin me emrin e italizuar Alesio, ngaqë përmendet në dokumentet mesjetare shumë shpesh, me kuptimin Aleks, Aleksandër. Ky emër lidhet edhe me emrin e Llesh apo Lekë Dukagjinit, si derivate të emrit më të plotë Aleksandër. Këto shpjegime etimologjike janë gjithashtu në rrafshin e etimologjisë popullore, dhe duhet thënë, se emri topik Lissitam çka parakupton rrënjën Liss, është një emër i mirëfilltë ilir, kuptimi i të cilit, për arsye të një lartësie tepër të skajshme mund të themi se nuk ka mbetur i zbrëthyer shkencërisht kënaqshëm deri më sot.

Lezha si qytet dhe biostrukturë përfaqëson diçka shumë të rëndësishme dhe të veçantë. Nga pikëpamja gjeometrike dhe ekologjike, Lezha, përbën një kaleidoskop të mrekullueshëm të natyrës, gati një lloj principate të pashembullt ekologjike, ku mali, fusha, pylli, monumentet arkeologjike dhe historike, laguna dhe deti përbëjnë një bashkësi të spikatur. Në këtë kuptim, Lezha, është e preferuara e shekujve, një sintezë e veprës së natyrës e të njerëzve me një vesk të ndritshëm të historisë e artit. Në portat e Lezhës mund të hysh pa trokitur, dhe duke e njohur fytyrën dhe thelbin e saj, vetëm mund të magjepsesh pambarimisht. Lezha është një grishje e përhershme dhe një estetikë e gjallë e sendeve dhe qytetërimit iliro-shqiptar, një stacion diturak i mijëvjeçarëve dhe i kënaqësive të veçanta të banorëve dhe të udhëtarëve. Çdo tregim mitologjik për Lezhën i paraprin historisë së saj plot motive dhe kontraste nga më të ndryshmet. Jo më kot, kronikanja dhe eruditja bizantine Ana Komnena, në shekullin XII, e quan Lezhën një qytet të ngritur në ajër, që mund të shihet nga të gjitha anët. Lezha është një qytet, ku janë përplasur dallgët e pafundme të historisë së Shqipërisë. Atje ka qenë Jul Cezari, dhe po atje, Gjergj Kastrioti, u kërkoi besën princërve shqiptare. Zbulimi më i madh arkeologjik i epokës së bronzit, është gjetja e thesarit prej 120 sëpata prej bronzit, shumica të vogla, të tipit kelt dhe të tjerat më të mëdha te tipit "dalmato-adriatikas". Ky thesar u gjet në Torovicë, 13 km në veri të Lezhës. Për historianet, Lezha, si qytet me hershmërinë e saj, përfaqëson një qerthull të një fisi ilir, prej të

cilit trashëgonte emrin e tij "Lissitan". Ka një rimëkëmbje të Lezhës në fillimin e shekullit VI. Kështjella e Lezhës është në listën e rindërtimeve të mëdha të Perandorit ilir Justiniani i Madh dhe përmendet në librin e Prokopit të Çezaresë.

Faza urbane nis dhe dokumentohet nga autorët e lashtë dhe përmendet me emrat Lis, Lissos, Lisso, Lissum. Banorët e qytetit janë qua Bizantinët genë: Lissios dhe Lisseus. Jeta qytetare është fryt i zhvillimeve në strukturën ekonomiko-shoqërore në Ilirinë Jugperëndimore gjatë shekujve 5-6 para erës sonë. Në të vërtetë kemi të bëjmë me epokën e jetës qytetare, në të gjitha qendrat e mëdha në bregdetin lindor të Adriatikut, me njëkohësinë e strukturimit qytetar në Shkodër, Ulqin, Rizon e të tjera. Duke u bazuar në formën e mirëfilltë dhe të plotë të Qytetit të zhvilluar të Lezhës, me përfundimin tipik të sistemit mbrojtës, mund të cakto-

para erës sonë. Ky autor i jep hapësire në përshkrimet e tij luftërave iliro-romake, ngjarjeve, që u zhvilluan në token ilire gjatë luftërave maqedono-romake, gjate viteve 264 dhe 146 para erës sonë. Qyteti i Lezhës është emër kryesor në traktatin e paqes, ndërmjet mbretëreshës ilire Teuta dhe përfaqësuesve të Romës në vitin 229 para erës sonë. Lezha caktohet nga romaket si kufiri më jugor i lundrimit të anijeve luftarake ilire në Adriatik. Fakti, që romaket e njohin këtë qytet, është domethënëse. Por, kufizimi i lëvizjes së Flotës Ilire nuk u respektua gjatë, në vitin 220 para erës sonë, strategu i famshëm ilir Skerdelajdi së bashku me Demeter Farin, u nisen nga bregdeti i Ilirisë me 90 anije, kaluan kufirin tabu të Lezhës dhe vazhduan lundrimin luftarak në drejtim të ishujve Kyllade. Është pikërisht Polibi, i cili thotë se Filipi V, mbreti i Maqedonisë shpresonte të shtinte në dore Lezhën dhe Akrolisin. Ai

lehte i nisi sulm drejt kodrave. Vendasit i thyen lehte pararojat e Filipit dhe duke marrë guxim nga kjo dolën nga qyteti dhe zbriten në fushë. Të njëjtën gjë, bene edhe ushtarët që ruanin Akrolisin, që kujtuan se Filipi u kthye dhe po tërhiqej nga fusha e betejës. Por, në këtë çast, ushtarët maqedonas, që ishin të fshehur u turren me force kundër ilireve. Gjithashtu edhe ushtarët e armatosur rende në fushë të Filipit kundërsulmuan. Trupa mbrojtëse e Akrolisit nuk pati kohe të rikthehet në fortifikimin e tyre, sepse ju pre rruga nga ushtarët maqedonas, që i kishin zënë prite. Fale kësaj strategjie dinake, Filipi V, mbas luftimesh të mëdha dhe të përgjakshme e pushtoi Lezhën dhe Akrolisin. Kjo gjë ndodhi në vitin 213 para erës sonë. Filipi V me 216 dhe 214 para erës sonë kish sulmuar dy here edhe qytetin e Apolonisë dhe kish kërcënuar edhe Epidamnin, por nuk mundi t'i pushtonte. Por



jmë se jeta urbane e tij lidhet me fundin e shekullit IV para erës sonë. Të rralla janë qytetet antike të Shqipërisë, që kanë ndërtime mbrojtëse të fortifikuara, aq të bukura dhe të fuqishme për nga ndërtimi, teknikat e ndërtimit dhe pozicioni. Lezha është një nga qytetet më të mëdha dhe më të fortifikuara të krejt Ilirisë. Madje, sistemi i fortifikimit të Lezhës, është më i fuqishëm se ai i Apolonisë. Lezha funksionon si qytet bregdetar dhe njëkohësisht si liman lumor, në skajin më jugor të shtetit ilir të Ardianeve dhe spikat për rolin e rëndësishëm në shekullin III para. K. Lezha është pike strategjike për lëvizjen e Flotës Ushtarake Detare Ilire dhe behet një qendër emblematike në kohën e sundimit të mbretëreshës ilire, Teuta, e cila riorganizoi dhe fuqizoi Flotën Detare Ilire për operacionet luftarake ndaj Epidamnit, Korkyres, qyteteve të tjera të Greqisë, deri në thellësi të Mesdheut. Qyteti i Lezhës dhe fortifikimi i tij Akrolisi, për here të pare, shënohet në burimet historike nga historiani Polidi, i shekulli II

përpiloi një plan strategjik, u nis me ushtri të madhe tokësore dhe mbas një udhëtimi 2-ditor, qëndroi pranë lumit Ardoksan, pranë Lezhës. Polibi u impresionua dhe që i kujdesshëm para këtij qyteti të fortifikuar shumë mirë. Akrolisi ishte më i lartë dhe akoma më i fortifikuar, duke e bere të pamundur pushtimin e tij.

Filipi V, synoi në hapësirën midis Lezhës dhe rrezes së malit të Akrolisit. Ai pjesën më të zgjedhur të ushtareve të armatosur lehte e fshehu në disa lugina të pyllëzuara nga ana e brendshme e tokës. Me pjesën tjetër të ushtrisë, ai sulmoi nga ana e detit nga perëndimi. Polibi shënon "brenda në Lezhë ishin grumbulluar forca të mëdha, nga krahinat e afërme ilire, të ardhura menjëherë aty, sapo kishin dëgjuar për ardhjen e Filipit. Sa për Akrolisin iliret kishin besim aq të madh në fortifikimin e tij, saqë kishin lenë atje vetëm një ushtri të paket për ta ruajtur". Ahere Filipi V përdori një strategji ushtarake, mbajti në fushë ushtarët e armatosur rende, kurse ata që ishin armatosur

pushtimi maqedonas që i shkurtër. Është Polibi, që e përmend qytetin e Lezhës, në shekullin e II para erës sonë si qytet rezidencial i Gentit, të famshëm dhe të fundit ilir.

Në këtë qytet të fortifikuar, Genti, priti delegacionin maqedonas, të dërguar nga Taseu, mbreti i Maqedonisë, për të finalizuar një marrëveshje e për lidhjen e një aleance miqësore mes shtetit ilir dhe atij maqedon. Këto bisedime me kthim dhe dërgim delegacionesh përfunduan në qytetin Meteon të Labeatise. Marrëveshja u arrit dhe mbreti Gent dërgoi përfaqësuesit e tij së bashku me ato të Perseut për të shkuar në ishullin e Rodit për të bere së bashku një aleance trepalëshe kundër Romës. Sipas kronikave historike, Genti i pozicionuar në lufte të hapur kundër romakeve, mblodhi në qytetin e Lezhës 15 000 luftëtarë të armatosur. Ai nisi një njësi luftarake prej 1000 këmbësorësh dhe 10 kalorësish të kryesuar nga i vëllai, për të nënshtruar fisin e Kavove, ndërsa vete u nis kundër qytetit ilir Basanje, 5

milje larg Lisit, që në atë lak kohor ishte aleat i romakeve. Gjithashtu, Genti dërgoi edhe 80 anije, për të plaçkitur tokat e epidamnasve dhe apoloniave, që ishin pro Romes. Këto veprime të Gentit patën një kundërveprim të fuqishëm të romakëve dhe në luftën iliro-romake të vitit 168 para K., Genti u dorëzua në qytetin e tij, që ishte kryeqendër e shtetit ilir, Shkodër. Duke parë burimet e lashta dhe të dhënat e autorëve antike, mësojmë se për themelimin e qytetit të Lezhës i atribuohet një rol kolonizues një personaliteti të njohur të kohës: Dionisi Plak, tiran energjik i Sirakuzës. Kështu, Diodori i Sicilisë, që ka jetuar në kohën e Jul Cezarit dhe Augustit, thotë se Dionisi plak, kishte projektuar një fushatë të kolonizimit të bregdetit ilir të Adriatikut me drejtim nga

perëndimi në lindje dhe kish dërguar kolonë për të themeluar qytetin e Lezhës, në vitin 385 para K. Kjo e dhënë historike është marrë si e mirëqenë nga shumë dijetarë, por edhe është vënë në dyshim nga dijetarë të tjerë e historian. Në të vërtetë, që në shekulli XVIII, nga dijetari Lucius është vënë në dyshim themelimi i një kolonie sirakuziane në Lezhë, i cili thotë se ka një ngatërrim dhe lapsus grafik të emrit në kronika; se nuk është themeluar qyteti Lissos, por qyteti Issa, në Ishullin Hva në bregdetin Dalmat.

Pra, ky ngatërrim toponimik, ka krijuar një debat në rrafshin e dijetarëve historianë. Një analizë të hollësishme të tezave mospërputhjes për kolonizimin ose jo nga ana e Dionisit Plak të Sirakuzës, është bërë nga dijetari G. Novak, i cili është nga njohësit më të mirë të veprimtarisë kolonizuese të Dionisit Plak në Adriatik. Në të vërtetë teza se, Lezha është themeluar nga Dionisi Plak i Sirakuzës më 390-394 para K., është hedhur poshtë me argumente të shumta të dala nga gërmimet arkeologjike nga ana e dijetarëve shqiptarë, por edhe më parë nga arkeologë të huaj. Ndonëse nuk mund të mohohet historikisht një ndikim nga perëndimi në Lindje i Dionisit Plak të Sirakuzës edhe në Lezhë, prapëseprapë nuk mund të bëhet fjalë për një kolonizim, sepse mbarëvajtja e Lezhës si njësi e plotë qytetare në shekullin IV para erës sonë, qe një realitet i pamohueshëm dhe se deri më sot nuk janë gjetur dëshmi dhe gjurme të kulturës saraguziane, as monedha dhe as objekte materiale të Sirakuzës në qytetin e Lezhës.

Themelimi i qytetit të Lezhës është një çështje e hapur shkencore, por teza e autoktonisë ilire të qytetit të Lezhës, që paralelizohet në të njëjtën hapësirë kohore edhe me qytete të tjera ilire të mëdha, është më bindëse dhe më e sakte. Lezha, si qytet me hershmërinë e saj, përfaqësonte një qerthull të një fisi ilir prej të cilit trashëgonte emrin e tij Lissitan. Ky emër dokumentohet nëpërmjet monedhave të prera në këtë qytet. Më vonë, Lezha, do të jete kryeqendra e krahinës së banuar nga pirustët, që sipas Strabonit bënë pjesë edhe në fiset ilire panone, që patën prijës Baton, gjë që tërthorazi jepet



edhe nga dokumente të tjera. Pirustet dhe desidiatet dalmate, në gjysmën e dyte të shekullit I, janë quajtur nga dijetari romak Paterkuli si të pathyeshëm, jo vetëm në saj të pozitës së vendeve dhe maleve, por dhe të natyrës së tyre të egër dhe të zotësisë së tyre të çuditshme luftarake. Dijetari Tit Livi dimensionon zonën-ushtri të fisit ilir të pirustëve, konkretisht ndërmetjet taulanteve, desaredeve, banoreve të Rizonit, Tivarit, Ulqinit dhe Shkodrës. Në kohën e mbretit ilir Gent, fisi ilir i pirustëve përbente një nga forcat kryesore të tij luftarake kundër romakëve. Edhe pas pushtimit romak të Ilirisë, pirustët zhvilluan rezistencë të ashpër dhe për të shuar kryengritjet e pirustëve vjen vete në Iliri, Jul Cezari. E tere historia e mësipërme, tregon jo vetëm lëvizjet e mëdha nga Lindja (maqedonasit) dhe nga Perëndimi (romaket), por edhe vete strukturën e organizuar të ilireve, luftërat e tyre për liri dhe mosnënshtrim dhe caktimin e Lezhës si një qytet emblemantik, emri i të cilit referohet në traktate apo në kronika të rëndësishme të ngjarjeve me karakter nder ballkanik por edhe mesdhetaro-adriatikas.

Qyteti antik i Lezhës është i vendosur në një terren të dyfishtë: kodrinor dhe fushor dhe muret rrethuese përfshijnë një sipërfaqe prej 20 ha. Urbanistika e qytetit të fortifikuar ka katër zona kryesore:

1. Zona e pjesës së sipërme, e vendosur në maje të kodrës,
2. Zona e pjesës së mesme, është e shtrirë në shpatet kodrinore,
3. Zona e pjesës së poshtme, është poshtë kodrës,
4. Zona breglumore, është me shtrat të lumit Drin dhe murit perëndimor të qytetit.

Sipas studiuesit Ivica Knezhoviq, secila nga këto zona, ka pasur një funksion të veçantë dhe njëkohësisht të ndërlydhur. Kështu, ka ekzistuar nga zona e I deri tek e IV, ku duke respektuar dhe pozicionin natyror të mbrojtur, dhe shtrirjet urbane kane qene vendosur Institucionet shtetërore, territori i banuar në mënyrë të dendur, qendra zejtaro-tregtare dhe më poshtë porti lumor, që ndërlydhte Lezhën me tere rrugët detare të Adriatikut. Pjesë përbërëse e Lezhës ishte Akrolisi, që ishte

në piken kulmore dhe më të veçante të sistemit mbrojtës të qytetit. Planimetria urbanistike e Lezhës është e veçante dhe e papërsëritur në asnjë nga qytetet ilire të njohura deri më sot. Mund të thuhet se moduli urbanistik i Lezhës antike nuk është bere sipas shembullit të qyteteve bashkëkohorë në Greqi, Maqedoni dhe Epir, por nuk mund të karakterizohet tipologjikisht si qytet me akropol. Urbanistika e periudhës ilire trashëgon deri më sot, planimetrinë e mureve rrethuese, kullat mbrojtëse, të gjitha hyrjet dhe një pjesë të rrugës kryesore të pjesës së poshtme të këtij qyteti. Në planimetrinë e Lezhës ilire, përcaktohen qarte 11 porta të mëdha dhe të vogla, që lejonin të hyje në qytet në të gjitha drejtimet. Nga këto, dy janë në pjesën e sipërme, 6 në të mesmen dhe 3 në qytetin e poshtëm. Në qytetin e sipërm, porta kryesore ka qene e vendosur në anën lindore për të komunikuar me Akrolisin, porta e dyte ishte në anën Veriore, që e lidhte qytetin me zonën fushore, me krahinën veriore. Porta më e madhe ka një hapësirë drite prej 4,20 m dhe në zgjidhje planimetrike është krejt e veçante në krahasim me të tjerat. Një tjetër porte e veçante e qytetit quhet porta e burimit, sepse kishte lidhje me një burim uji në afërsi të saj. Në qytetin e mesëm porta kryesore quhet ajo e Gaviavit. Si element karakteristik të portave të qytetit janë përmasat e tyre madhështore, gjë që nuk vihet re në qytete të tjera ilire. Zgjidhjet e tyre arkitektonike janë përshtatur me terrenin, pjerrësinë dhe funksionet përkatëse. Brenda qytetit të Lezhës, ruhet dhe rrjeti i rrugëve të degëzuara dhe të kryqëzuara në brendësi. Nga të jashtmet, që hyjnë në qytet janë tri, ajo që vinte nga Jugu, një tjetër nga Veriu dhe e treta nga Verilindja. Skema e mureve mbrojtëse të Lezhës përfshin një gjatësi prej 2600 m. Jo më kot, Polibi ka fiksuar përshtypjen shumë të madhe, që i bënë këto mure mbretit Filipit V të Maqedonisë. Pjesa e sipërme e quajtur Akrolis është pjesa më speciale e fortifikimit. Trajtimi stilistik i mureve përmban dy stile ndërtimi, që i përkasin një faze të vetme kohore, që lidhen me veçoritë stilistike dhe morfologjike të mureve epirote-ilire. Nga një llogaritje e përafërt del se janë

afro 100 mije metro kub gurë dhe mbi 80 mije cope bloqe. Kjo kryevepër inxhinierike ndërtimore është e pashembullt në territorin shqiptar.

Si mbas Polibit kjo kryevepër artistike i takon shekullit II-III para Krishtit. Një skulpturë tjetër është figura e një njeriu, gdhendur në një bllok guri me shtat mesatar dhe me një kapele të "tipit pileus" në koke. Kemi dhe dëshminë e skulpturave të vogla prej balte të pjekur. Është gjetur një kallëp prej balte të pjekur (një matrice), që ka shërbyer për riprodhimin e figurimave të quajtura terrakota. Nga kallëpi riprodhohet një skene mitologjike në miniaturë, që paraqet tre figura të vendosura në mes të një sfondi me elemente zbukurimore,

të imituar nga arkitektura monumentale e kohës helenistike. Artizanati dhe zejtaria Artizanati ndërtimor lidhet me prodhimin e tjegullave dhe pllakave prej balte, me poçerinë vendase shumë të zhvilluar. Një numër tjegullash mbajnë vulën e pronarit të punishtes me emrin EOBTATIO. Ky emër lidhet me të njëjtin emër, që gjendet edhe me monedhat e gurvarret e zbuluara në qytetin e Durrësit. I madh është numri i amforave të zbuluara këtu, disa prej të cilave kane edhe vula në forme simbolesh apo monogramesh. Në disa amfora vula ka të rafiguruar lulen e shegës, simbol ky i njohur për amforat me prejardhje nga Ishulli i Rodit. Një vule e një amfore tjetër mban emrin illr Gent dhe emrin tjetër po ilir Suri, pronar i punishteve vendase. Janë gjetur edhe ene tryeze me kanilyra të tipit inafie dhe ene të tipit megara. Këto objekte i përkasin si kohe shekullit III para Krishtit. Me interes janë dhe objektet prej bronci apo dhe prej hekuri si fibula, byzylkë, unaza, gjilpëra, grepa peshkimi, thumba dhe gozhde të vogla, maja heshtash, shpata e të tjera. Nga një gur varri i gjetur në Lezhë, i shekullit II para Krishtit, mësojmë emrin e arkitektit Hieroni, i biri i Leonit. Është fjala për një arkitekt, që ka punuar në këtë qytet ilir. Monedhat janë gjetur shume monedha prej bronci dhe argjend. Koleksioni numizmatik i Lezhës, përfshin shumë monedha me origjinë nga Durrësi me siglën "DYRR". Këtu është gjetur dhe monedha e mbretit ilir Balaios, prere me 167-135 para Krishtit. Një numër i konsiderueshëm monedhash janë nga prerjet autonome të qytetit të Lezhës, të cilat imitojnë ato të Shkodrës. Ato mbartin legjendën LISSITAN dhe kane elemente zbukurimore tepër tipike, siç është figura e anijes Liburne. Këto prerje janë bere me 229-213 para Krishtit. Simbole të këtyre monedhave janë figura e Zeusit me trekëndësh, e Artemisit me rufe, ose me figurën e dhisë. Përdoret dhe figura e mburojës dhe përkrenares ilire. Të gjithë këto elemente lidhen me botën e mirëfilltë ilire dhe duket qarte ndikimi labeat i Shkodrës, si kryeqendër e shtetit ilir.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

RIKUJTESË: SHQIPNIA E PA “PA ZBULUEME” FUSHA E LIQENIT-CUKAL

Duket si lojë fjalësh, por asht reale e plotësisht e vertetë! Na, shqiptarët interesohemi e studjojmë vendet ma të largëta të Globit, tregojmë e flasim me hollësi e entuziazëm për të gjitha pikat turistike të Ballkanit e të Evropës, por nuk njohim vlerat turistike të vendit tonë!

Kështu ndodh edhe me ne që jetojmë në Veriprendim të Shqipnisë; nuk dijmë e as nuk njohim “vlerat mjedisore turistike”, që i kemi rreth nesh, për rreth Shkodrës!

Në asnjë agjendë egzistuese të publikueme deri sot, prej institucioneve që trajtojnë fushën e turizmit në Shkodër e rreth sajë (Bashkia Shkodër, Bashkia Vau Dejës, Ministria e Turizmit, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, agjencitë turistike, shoqatat e fushës së turizmit) nuk përmendet e nuk egziston asnjë material tregues, sado modest, për një perlë të turizmit alpin që ndodhet vetem 36 km larg qytetit të Shkodrës!

Po të marrim rrugën drejt Urës së Mesit, Drishtit, “Murit të Turkut”, midis fsharit Ukbibaj e Vukaj (Shllak) e të vazhdojmë nëpër rrugën egzistuese të shfrytëzimit pyjor, mbas pak do të gjindemi në “Fushën e Liqenit” të malit të Cukalit, që ka një sipërfaqe prej 20 ha e pozicionueme në naltësinë 1350 m mbi nivelin e detit, qendra e dikurshme e shrytëzimit pyjor në malin e Cukalit. Fusha ka një pjerrësi natyrale të ambel e asht e rrethueme pothuaj prej të tana anëve prej pyjeve të ahut që mbushin naltësitë malore të Cukalit (rreth 250 m mbi fushën) prej ku buron edhe ujë i pishëm. Gjelbërimi i barit dhe lulet alpine egzistuese i japin mjedisit një pamje fantastike që të kujtojnë pikturat impresioniste të Monnes së Madh.

Rruga prej qendrës së Shkodrës deri te Muri i Turkut e gjatë 24 km ka gjanësi 6 m e vetem 10 km e para të saja janë të asfaltueme. Vazhdimi i rrugës prej 12 km deri në destinacion ka gjanësinë 5 m. Rruga gëzon një taban solid shkambor me pjerrësi minimale e kthesa të buta simbas normave teknike për ndërtimin e rrugëve malore. Kamionat e shfrytëzimit pyjor si dhe mos mirëmbajtja prej vjetëve e rrugës, i kanë krijuar në mesin e sajë të ashtuquejtën “karrexhatë”, një “kurriz” në mesin e saj që mundet me shqetësue udhëtimin e veturave të ulta, por jo të naltat.

Panoramata që të mundëson rruga e destinacioni janë të veçanta e mbresëlënëse; deri te “Muri i Turkut” rruga kalon afër pyllit të kshetjave kurse pamja prej nalt e liqenit të Vaut të Dejës, qytetit e liqenit të Shkodrës mbeten të paharrueshme...



Nga e majta në të djathtë: Prele Milani (anëtar i kryesisë së SHAD), Karlo Kamsi (inxhinier), (?), Luigj Shyti (Sekretari i SHAD), Ndue Sanaj (Kryetari i SHAD), dom Ardian Arra, Hil Kodra (kryetari i komunës Shllak), Filip Guraziu (Drejtor kompanise se sigurimeve ALBSIG), Sabri Bushati (Drejtor i Telekomit dhe anëtar i Këshillit të Qarkut Shkodër) dhe ulur Nikolin Kulari (muaji gusht 2010).

Afersia prej qytetit të Shkodrës, vetëm 36 km, naltësia prej 1350 m mbi nivelin e detit si edhe kushtet egzistuese mjedisore të tregueme ma sipër, i japin pikës alpine të “Fushës së liqenit” një vlerë shumë të

turistave të huej e tashma edhe vendas.

Gjatë periudhës dimnore relievi i “Fushës së liqenit” paraqet një vend shumë të përshtatshëm për zhvillimin e sporteve dimnore (te skive e të tjera).



Pamje të Fushes së Cukalit dhe ndërtesat e sektorit pyjor të tij

madhe për zhvillimin e turizmit malor.

Gjatë periudhës së Verës konsiderohet vend ideal për jetesë me freskinë e klimës malore ku shtigjet kambësore egzistuese favorizojnë ma së miri sportin e ecjes sportive, shumë të preferuem prej

Naltësia, e pozicioni i relievit të “Fushës së Liqenit” favorizojnë borën për një periudhë relativisht të gjatë.

Merret me mend se për shfrytëzimin turistik (të organizuem) të resurseve sipërtregueme duhet të parashikohen disa

ndërhymje në infrastrukturën egzistuese:

a. Në segmenti e parë prej 24 km, deri te “Muri i Turkut”, rruga duhet të zgjanohet me 1 m, kurse në segmentin e dytë malor prej 12 km, zgjanimi nga ana e malit (që ka strukturë dhumë të lehtë për ndërhymje) duhet të jetë së paku 2 m, për me i dhanë kështu, gjanësinë prej 7 m e natyrisht që duhet edhe vendosja e pritave anësore si dhe sinjalistika rrugore.

b. Destinacioni turistik nuk ka furnizim me energji elektrike, ç’ka duhet instalue.

c. Burimi natyror i ujit, që ndodhet shumë afër “Fushës së liqenit” ka prumje të vogël, çka krijon nevojën e projektimit për me shfrytëzue burimet ujore alternative në zonë.

Kujtojmë se mungesa e ndërhymjeve në infrastrukturë, si ma sipër tregue, nuk pengon organizimet spontane turistike që duhet të kenë për qëllim, përveç kënaqësisë që fitohet prej pjesëmarrësve edhe publicitetin e vlerave mjedisore turistike të “Fushës së Liqenit”.

Autori i këtyne rreshtave, së bashku me një grup qytetarësh shkodran dashamirë të promovimit të vlerave turistike të zonës, para pak viteve, organizuen një shetitje me karakter njohës të zonës në fjalë dhe entuziazmi që u fitue nuk mund të harrohet! Si fillim, për nxitje interesi dhe njohje publike të këtij mjedisi turistik mund të rekomandohet organizimi i një feste lokale në një datë që malësia (krahina) e Shllakut e ka në traditën e sajë, ku të paraqiten vlerat e zonës; tradita gastronomike, punimet artizanale të banorëve, etnografia e veshjeve karakteristike, të shoqueme me koncerte me kangë e valle folkloristike e të tjera.

Kjo pikë turistike alpine konsiderohet dhe asht “vlerë shtesë” mée shumë randësi për zhvillimin e turizmit (veror dhe dimnor) në zonën rreth Shkodrës. Distanca e shkurtë dhe mjedisi i freskët (falë naltësisë) gjatë ditëve të nxehta të verës, favorizojnë popullsinë e zonës së Shkodrës e të rrethinave për një jetesë me kushte klime ideale, kurse në periudhën e dimnit turistat amatorë të sporteve dimnore nuk do të kenë ma nevojë që të spostohen me qindra km deri në Kolashin ose në Brezovic, por vetem 36 km larg qendrës së qytetit të Shkodrës.

Uroj e shpresoj që shkrimi mos me rënë në “veshë të shurdhuem”, por të ngacmojë sadopak “gjumin letargjik” të atyne që e kanë për detyrë promovimin e vlerave turistike mjedisore në veri të Shqipnisë!

Filip Guraziu

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
Edmira e Luigi Mazzeo

